

Dionis Bubani

Ujet
muk shuker

- Ujersha -

• 1959 •

DIONIS BUBANI

~~27266~~
BIBLIOTEKË E SHTETIT
TIRANË
11505

YJET NUK SHUHEN

TIRANË, 1959

YJET NUK SHUHEN

Shkëlqejnë si dy yje sytë e tu
në qjellin e pasjonit tonë.
Vështromë drejt në sy të rri ashtu
si fushave kur rrinim natën vonë.

Shkrojta për ty të parën poezi,
të fundin varg për sytë e tu do shkruaj,
por mos më thuaj kurrë: — «Sytë e mij
për jetë do shkëlqejnë!»... mos më thuaj

Shkëlqejnë si dy yje sytë e tu,
po pse të të gënjej, o zemra ime?
Një ditë larg, oh kushedi se ku
do shuhen sytë e lodhur n'ëndërimë.

Do shuhen këto yje n'inifinit
si yjet që po treten nëpër erë...
Sinqeriteti im po të çudit?
Gjer sot s'të kam gënjyer asnjëherë...

... A të kujtohet kur vështronim ne
yjet që binin lart në hapësirë?
Miljarda vjet kalojnë përmbi dhe
e yjet treten si çelik i shkrirë!

Miljarda vjet kalojnë përmbi dhe
e yjet shuhen si kandil i zbetë.
As Perëndia që u lodh në re
s'i mban të ndezur yjet lart për jetë!

Por ne i ndezëm yjet në Agim,
e zbukuruam botën në një natë, —
dhe u habit e Zoti, pa dyshim,
si nuk u çlodhëm as ditën e shtatë!

I ngjitëm yjet lart, me hap krenar,
në Univers të ndizen me miljona, —
yjet e Socializmit fitimtar
të fluturojnë por si ëndrat tona...

Në qjell do duken yje përsëri,
do ndizen yje ku çdo yll ka rënë.
... E dashur, ndoshta nesër un' e ti
do fluturojmë lart deri në hënë...

Sa yje do shikojmë ne atje,
sa yje mbi raketa dhe flamurë.
... Por mos harro sa gjak u derdh rrëké
që këta yje mos të shuhen kurrë!



AGIMI YNE

KUJTIME FËMINIJE

Si në vegim kujtoj ditët e para
kur rri e vështroj yjet n'ëndërimë.
Sa vite po më dalin sot përpara, —
o vite ju të fëminisë sime,

me trena dhe fabrika dhjetë kate,
me bulevarde, kisha dhe me ura,
me sheshe, e kalibe dhe pallate,
me pluhur, me asfalt dhe me vetura,

me parqe dhe me plehra ndër majdane,
me lypësa kudo e miljonerë,
me trame, dancig-bare dhe mehane,
me sazexhinj, me lotë dhe me verë!

O Bukuresht, më del para oborri
i ngushtë, me një çezmë dhe një hije, —
atje linda dikur një dit' Shtatori, —
ti më përkund kujtime miturije!

Dhe prej oborrit dolla në rrugicë
ku renda i pluhurosur, i dërsitur.
Si çilimi, në vapë dhe në ngricë
dhe lulet dhe dëborën kam soditur...

Pa ngrënë nuk kam fjetur asnjëherë, —
këpuçë blinja shpesh...

... Po për karshi
mbaj mënd, si sot, dy krisma në pranverë:
vrau vehten një baba me tre fëmi!

Kudo më kot kish rendur, s'gjente punë
dhe gruaja e re ish e sëmurë.
As shtatë vjet s'i kisha mbushur unë
por këtë varrim s'mund ta harroj dot kurrë.

Karrocën e tërhiqnin katër kuaj, —
sa britma kam dëgjuar atë ditë.
Me një vështrim të çmëndur e të huaj
e veja pas qivurit me fëmitë...

Përpara kishës rrinin plot lypsarë,
të krusur bëlbëzonin si të mpirë.
Sa zonja miljонерësh që kam parë
duke u hedhur ndonjë «lei» mëshirë.

Në kishë hynte shpesh ndonjë kokonë
me dhjetë shërbëtore te shtëpia
t'i faleshin mëkatet dhe më vonë
ta merte në parajsë Perëndia...

* * *

Dhe kisha miq të dashur, të pandarë, —
ndër zemrat tona një shkëndi u ndez:
rumunë, polonezë dhe bullgarë,
dhe shokët më thërrisnin «albanez»!

Po! Isha shqipëtar! Dhe Shqipëria
ish larg, ish larg, tej malesh ish diku...
Atdhe, s'të kisha parë, por lavdia
ndër shekuj e dëshmorëve të tu,

betejat dhe fytyra legjendare
dhe shpata fitimtare e Skënderbeut
më ngjallën mua ndjenjën kombëtare,
më ndezën dashurinë e mëmëdheut!

Një mbrëmje Prilli rrugëve bërtitën
çunakët:

«Po sulmohet Shqipëria».

Sa shpejt gazetat qosheve u shitën
me tituj:

«Do zbarkojë Italia»

Ka çaste kur një zemër s'mund të heshtë
dhe kur e di se ka kudo xhandarë.
Po bisedonin njerëzit e thjeshtë
për shqipëtarët trima dhe krenarë.

Ndokush mendonte ndoshta Rumaninë
me legjonarë dhe me kryq të thyer,
se dhe Karoli puthte tradhëtinë,
me gjak puntorësh duart i kish lyer!

Më dukej vehtja sikur isha mplakur...
Sa e trishtuar ish ajo pranverë!
Në ato çaste Prilli të përgjakur
me dëshpërim urrejtja ish përzierë!

Më kish plakosur dhimbja dhe hutimi, —
fashistët po pushtonin Shqipërinë.
Atdheu ishte larg, por Mujo trimi
vdiste hero! Lart mbante krenarinë!

* * *

Avitej lufta. Topat ishin ngritur,
po zgjoheshim me drojë çdo agim.
Avitej lufta! Rrugëve papritur
sirenat na shqelmonin në strehim.

Dhe maska anti-gaz na kishin dhënë, —
filloi nga pak kjo fëminija ime
që të dëgjojë se dikur një nënë
kish humbur të dy djemtë në luftime.

Rizgjoheshe ndër mënd lufta e parë
me tankse, zepelina dhe uri.
Dikur sa nuse burrat kishin qarë,
sa nëna kishin mbetur pa fëmi!

Dhe më tregonte gjyshja duke qarë
kur bënte kryqin dhe këmbanat binin:
— «Ashtu këmbanat binin dhe më parë
kur natën sillte vdekjen zepelini!»

Ish si një tingull vdekje çdo këmbanë, —
më mblidhej zemra kuspull, pakuptuar.
Kur zgjohesha i trembur, gjyshja pranë
më përkëdhelte flokët e menduar!

* * *

Të pashë, Bukuresht, të fundit herë
nga larg, një mbrëmje Gushti plot me re.
Ish nisur treni, ikte por si erë,
në gjirin tënd më sillte, o atdhe!

Atdhe, atdhe i shtrenjtë! Zemra ime
po fluturonte dhe më shpejt se treni,
mbi kodrat dhe lëndinat me burime,
mbi alpet ku përposh shkëlqen liqeni.

Si dallëndyshe iku më përpara
dhe hyri në kasollen varfanjake
pa zjarr, ku muret kishin plot të çara
dhe s'kishte misër torba e një plake!

Atdhe, atdhe, të gjeta të plagosur,
por ballin lart e mbanje ti krenar.
Nuk të përkuli dot, e handakosur
sëpata e Liktorit tradhëtar!

Përpara teje mbeta përmëndore,
pa folur të vështrova me nderim.
M'u duk sikur ngadal në krah më more
dhe më pushtove, o atdheu im,

me qjellin tënd të ëmbël e të pastër,
me shiun dhe me erën e stuhisë,
dhe me pulbardhat por si alabastër,
me ëndrat dhe me shpresat e rinisë, —

me stanet dhe me delet me këmborë,
me vatrat dhe mik-pritjen shqipëtare,
me krojet dhe me kreshtat me dëborë,
me sulmet e një çete çlirimtare!

Në heshtje i sodita shpesh agimet
që skuqnin si flamuj Revolucionit.
Në gjirin tënd më lindën frymëzimet
dhe njerëzve u thashë: — «Më dëgjoni!»

NËN MURET E KËSHTJELLËS SHEKULLORE

Nën muret e kështjellës shekullore
jam shtrirë dhe kam rënë në mendime.
Çdo mur këtu më flet për një fitore,
për trimëri, për shpata dhe luftime...

Prej shekujve dhe gurët janë nxirë
dhe këmbanorja ra në gjum' të thellë, —
por bari përsëri simvjet ka mbirë
dikur siç mbinin lulet në kështjellë.

Shkëlqen në diell Kruja legjendare,
ullishtat poshtë kodrës hedhin hije...
Sikur dëgjoj dhe valët bregdetare
se duket deti-i kaltër me anije.

Dy botë gërshetohen prej lavdisë:
e shkuara me mbrojtjet heroike,
e ardhshmja me sulmet e rinisë,
me ëndrat e shëtitjeve kozmike!

Lokomotiva Dizël shket e qetë,
kombajna mbetet pas në mes të grurit,
çan reaktivi qjellin si shigjetë
dhe unë rri mbështetur pas një muri..

Më fort e dua vëndin tim plot dritë
me bjeshka, me liqej dhe hapësira,
kur po sodis në heshtje bukuritë
nën muret e kështjellave të nxira!

ROMANCA E HËNËS

Po ju thërras, o miqtë e mij poetë
që ëmbël më kënduat kurdoherë,
të niseni tani me një raketë
me vajza, me kitara dhe me verë

Ju pres dhe ju o miqtë e mij dashnorë,
ju që u puthët shpesh nën dritën time,
të vini lart në malet si kurorë,
se s'kam njeri, as këngë, as gëzime...

Me hirin tim të ftohtë, e mbuluar,
dhe rruga po më duket aq e gjatë.
Po udhëtoj mes reve e trishtuar,
në kozmos e menduar për çdo natë...

E kujt t'i them një fjalë edhe unë
kur djelli fshihet deri ndaj të gdhirë?
Rroj vetëm në rebesh e në furtunë
se yjet janë larg në hapësirë...

Kur do të vini do harroj vetminë,
mbi tokë do shpërndaj më shumë dritë.
Ju do më sillni ndoshta dashurinë,
prandaj ju pres me mallëngjim çdo ditë!

KËNDOJ !

Kur shqipen nuk e dinja mirë
qendronja von, gjer ndaj të gdhirë,
më zinte gjumi, vetëm fare,
i krusur përmbi abetare.

Oh, nuk e dinja gjuhën time
dhe mirnja dysha në hartime.
Skuqnin gabimet në çdo fletë
dhe i vështronja si i shkretë,
i pafuqishëm dhe i mitur,
përpara tyre i tronditur!

... Sa ndjenja, shpresa dhe kujtime,
sa tinguj ndrydhte zemra ime ...

Prisnja në heshtje, në dritare.
i krusur përmbi abetare,
të mbushej dhoma plot me dritë
dhe të këndonja ndonjë ditë
atdheun tim, njerzit e thjeshtë,
një stan, një arë dhe një vreshtë!

* * *

Përulem sot përpara teje
o gjuhë me shkëlqim rrufeje,
që rrite Budin dhe Naimin,
ti më dhurove frymëzimin...
Me ty po endem sot i lirë,
më lart, si shpend në hapësirë,
në ritmin tënd plot tingëllime

si një përrua me buçime!
Dhe jam i lumtur dhe i bindur, —
këndoј atdheun e rilindur,
këndoј fabrikat dhe çentralet,
kopshtijet, arat, pyjet, malet,
tokën me gjak e lot vaditur,
këndoј të ardhmen ton' të ndritur!



AGIMI YNË

Po rend kaprolli pyjeve,
hëna shikon në qjell tretjen e yjeve, —
dhe djelli tokën përshëndet
prej bjeshkëve gjer poshtë në bregdet.
Sa më pëlqen që ta dëgjoj këndezin
kur majë gardhit lajmëron mëngjezin
dhe në çdo kënd të tokës shqipëtare
çelen dritare!

Pushtomë frymëzim
me bukurinë e atdheut tim,
të endem larg, mbi gërxe dhe lëndina,
në krah të më shëtisë suferina,
edhe të zbres pastaj si një jehonë
atje ku prishen gardhet përgjithmonë.
Të thith aromën e agimit,
të më shkëlqejnë sytë prej gëzimit, —
të endem nëpër arë,
të ndjej si ngrihet afshi i brazdës por-sa çarë!

M'e bukur duket jeta!
Gruri u rrit ku shtriheshe kënetat,
dhe era përkul kallzat, valë-deti,
gadi mbulon kombajnën bereqeti.
Një traktorist ha drekën nënë hije
edhe lexon një letër dashurije...
Shiu shkëlqen prej rrezeve i ngjyer,
ylberi përmbi fshat rri i mbërthyer, —
çdo fije bari forcë mer dhe jetë,

e lartësohen avuj gjer te retë.
Një dallëndyshe po ndërton një çerdhe...
— «Mir' se më erdhe, moj mir' se më erdhe!
Prisha kasollen, ngrita një shtëpi,
këtu ndërtoje çerdhen përsëri!»

Dëgjohe larg një këngë në fushën pambarim,
ja, kooperativistët këthehen tok prej are,
dhe midis tyre ohe djaloshare
gufojnë për një vashë që do një tjetër trim.
Por lotët do të thahen se jeta na rrëmben
me vrullin e betejës që ka nisë,
me qeshjen e fëmisë,
me gonxhen që shpërthen.

Këthehet bagëtia,
këmbanat tingëllojnë, dëgjohen gjer përtej,
dhe larg me tërë krojet bashkohet melodia
që rënd nëpër bregore si gjaku nëpër dej.
Së shpejti ndizen dritat e centralit,
muzgu po zbret dalengadal prej malit, —
po nesër do agojë një djell si s'është dukur,
dhe fshati do të zgjohet m'i fortë dhe m'i
bukur!



ZGJIMI I METALEVE

*Në vëndin tonë do të ngrihen
furra të larta për shkrirjen e
metaleve.*

Prej shekuj po flenë të shtrenjtat metale,
s'i zgjuan rrufetë, stuhitë ndër male, —
po flenë si foshnjat me këngët e nënës,
nën dritën e djellit, nën rrezet e hënës!

Me ne do të zgjohen prej gjumit një ditë,
në djell t'u shkëlqejnë përjetë stolitë.
Në furrat e larta do shkrepë agimi,
në zjarr do shpërndajnë shkëndia gëzimi...

Atje do pushtojnë të fortë natyrën
në vallen e çmëndur kur ndrojnë dhe ngjyrën, —
kur dheu i ndarë shkëlqen si mermeri
dhe duket si ngrihet në flakë ylberi.

Në çastin e fundit do zbresë rrufeja
kur vrullshëm do shkasin në format e reja,
metalet e kuqe, të verdha, të shkrira,
që erdhën së largu nga malet e ngrira...

Prej shekuj po flenë të shtrenjtat metale,
s'i zgjuan rrufetë, stuhitë ndër male.
... Me ne sot po zgjohen, me ëndrat e para,
të rendim së bashku, përpara, përpara!

BREGDETI

11505


27266
BIBLIOTEKA E SHKËRITË
G. DORZHAJTES

Mbi kodër ngjitet fshati dhe poshtë shtrihet deti
i kaltër por si sytë e vajzës lozonjare.
Çdo zemër e mahnitur në këto brigje mbeti, —
këtu në çdo dritare
fryn era e përzjerë me lule portokalesh.
Në këtë vënd ku djelli shkëlqen që sipër malesh
dhe zhytet ëndrimtar
në detin pikturuar me ngjyra bregdetare,
natyrës shqipëtare
t'i falesh
o udhtar!

Këtu edhe po erdhe një ditë i trishtuar
me shpirtin e lënduar
thërret:

— «Do të jetoj!»

Dhe zemra rend përjashta, e lumtur në natyrë,
të endet mbi ullishtat, mbi detin si pasqyrë,
të prehet mbi limoj!



SHTEGU I HARRUAR

Këndeje kalonin burrat kur shkënin në kurbet,—
edhe im shoq këndeje është larguar!—
me mallëngjim një plakë po më flet
me zë të drithëruar.

—«Këndeje kalonin burrat kur shkënin në kurbet!—
Përballë ngrihen malet, kurorë madhështore,
dhe anës shtrihet fusha, e gjerë sa një det,
e zezë dhe pjellore.

—«Këndeje kalonin burrat kur shkënin në kurbet,—
te zalli kthenin kokën, me mall, të fundit herë,
dhe zhdukeshin së largu vaj-medet,
dhe qante nusja e mjerë!—

...Burimi rrëzë kodrës gurgullon...
Mos vallë janë lotët që derdhën dje gratë
kur i përcillnin burrat përgjithmon
dhe mbeteshin si qyqe ditë e natë?

—«Këndeje kalonin burrat q'u tretën larg në det!—
...Tëposhtë shtrihet shtegu i malit, i mbuluar
me bar, se sot askush s'ka udhëtuar
në shtegun e mallkuar që shpinte në kurbet!

O FSHATI IM I DASHUR

— kushtuar Boboshticës —

Më prit o fshat i shtrenjtë i gjyshërve të mi,
o ëndra ime e vjetër, o frymëzim i ri.

U linda larg atdheut, por të kujtova shpesh,
kur gjyshen kisha pranë ti ishe pranë nesh.

Për ty, për ty më fliste, për shelgjet dhe shtëpinë,
kur qante, ndoshta gjyshja kujtonte nusërinë

me burrin e sëmurë dhe pa gëzime fare,
me lotë dhe karvane, me ëndra në dritare!

O fshati im i dashur, s'të kisha parë kurrë
por dinja se ke mana të kuqe dhe një urë.

Në mes një shesh i vogël, një pjergull tej një muri,
dhe anësh rreth e rrotull shtëpi me plloça guri...

* * *

U rrukullisën vitet me djell dhe me furtunë,
dhe gjyshja më ka vdekur, u rrita edhe unë.

Nga larg të erdha pranë me mall e dashuri,
më prit o fshat i dashur i gjyshërve të mi...

Në gjirin tënd po endem dhe çlodhem në burime,
mbi bukur ti çdo ditë rilind përmbi rënime.


Në vënd rri i tronditur, një plakë po më thotë
se mbeti qyqe fare, një vajzë kish në botë,

por në oborr ia vranë, ia vranë atë ditë
kur pushkatuan pleqtë dhe dogjën çilimitë!

Nën çdo çati të djegur e nën çdo mur të rënë,
vdiq një fëmi në sisë, një motër o një nënë...

Por ti nuk derdhe lotë, si burrat ke luftuar,
se plagët nuk të mposhtën, o fshat i masakruar!

...Të kuqe i ke manat që shkunden në lëndinë,
me gjakun tënd i skuqe që ta gëzosh lirinë!



NJERIUT TE MADH E TE THJESHTE

PARËVERË

Atë mëngjez Simbirsku përsëri
u zgjua si një fshat, pa asnjë zhurmë.
Në çdo rrugicë kishte qetësi,
në pluhur mbetej rallë ndonjë gjurmë.

Qyteti s'kish fabrika dhe as tren,
dhe natën, sa dritare s'kishin dritë.
Këtë qytet të heshtur më pëlqen
që ta kujtoj me mall në këto ditë.

Atje, një ditë Prilli në agim
me Djellin që shkëlqente n'hapësirë,
lindi Vullodja, lindi si kushttrim
se do të thyhen pranga dhe zinxhirë.

Ish një mëngjez i kaltër dhe i qetë,
këndonin zogj edhe lodronin shqera...
Leu në pranverë dhe luftoi një jetë
kudo të lulëzojë parëvera!

TRYEZË E VOGËL

Tryez' e vogël, sa kujtime
më ngjall kur të shikoj atje
në kënd t'oborrit plot blerime
me këmb' të futura në dhe,

Rininë duke ëndëruar
Shikoj Vullodjen se si vjen.
I zbret një rreze e ndriçuar,
ndër kaçurela i shkëlqen.

Vullodja ve aty me radhë
fletoret, librat me kujdes.
Dremit mështekëna e bardhë
dhe trandafilli në mëngjes.

Sa qetësi! Ay çdo ditë,
me zell, me shumë dashuri,
fiton përhera dritë, dritë,—
mëson dhe s'është më fëmi!

Tryez' e vogël, sa kujtime
më ngjall se zemra s'të harron.
...Ndoshta këtu në ëndërrime
pa botën në revolucjon!

*) tryeza ku studjoi Lenini në vegjëli.

NË SHUSHENSKOE

O ti fshat i paharuar,
fshat i largët «Shu-Shu-Shu»,
oh sa vite kanë shkuar
që kur ish ay këtu.

Oh sa lule janë tharë
dhe sa çelën, kushedi,
që kur erdh për her të parë
në një natë pa njeri.

Çdo shtëpi, çdo gardh, çdo urë,
për Atë tani na flet.
Kur fryn era nëpër drurë
ndejmë zemrën si troket!

Dhe dëgjojmë edhe çapet
që aviten në shtëpi
kur del hëna dhe përhapet
pluhur ari mbi çati.

Lumi rrjedh e rrjedh ngadalë
dhe mes stepës gjarpëron.
Ndoshta kushedi, çdo valë
për Iliçin na tregon.

Hapim derën, këtë derë
me pllak' hekuri në mes.
Kushedi Ay sa herë
e ka çelur me kujdes!

Në oborr po qeshin lulet
kur po ndihen midis nesh.
Më e vogëla përkulet.
— «Mir' se ardhët», buzëqesh.



« PËRPARA SHOKË PROLETARË ! »

A tje, në mes të Siberisë
në fund të shekullit të shkuar,
Lenini këngën e lirisë
me popullin e ka kënduar.

Në internim, Nadjezhda pranë
i ngjallte frymëzim dhe shpresë.
..Lulet e mollës u shpërndanë
si flokë bore përmbi vesë.

Dhe fushave kish dalë bari,
dhe çilimitë po lodronin...
Ndër zemra ishte ndezur zjarri:
dhe të burgosurit këndonin!

1 Maj kish ardhur! Ditë e madhe
me lule, këngë dhe këtu.
Ata këndonin në livadhe,
buçiste fshati Shu-Shu-Shu.

Dhe natën vonë po kumbonte
një marsh beteje si më parë.
Iliçi me sa zjarr këndonte:
—«Përpara shokë proletarë!»

NË ZEMRAT PROLETARE

Ç'kërkoni si të çmëndur, o junkerë?
Leninin?

Mos u lodhni kot...
I thoni pra Ohranës¹⁾, o të mjerë
se s'mund ta gjeni dot!

Atë e ruan udha n'errësirë
dhe hija nëpër pyje,
deti Baltik i ngrirë
dhe nata plot me yje!
Dhe reja në shtërgatë
dhe era pranverore.
E ruan për çdo natë
kasollja punëtore
dhe garda marinare, —
Lenini

rron

në zemrat proletare!

1) policia cariste



LOKOMOTIVA 542

*Revolucjonet janë lokomotivat
e historisë.*

(Karl Marks)

Mbas pak lokomotiva do marshojë, -
me sa kujdes Iliçi furrën ndez...
... Si makinist do të kalojë
kufirin filandez.

Në Peterburg e presin qindra mija, -
u nis lokomotiva, fluturon...
...Tani marshon me 'të dhe historia
për në Revolucion!



VITI I URISË

1919.

o vit i paharuar...

Kërkon pak bukë foshnjëza e shkretë
dhe e zë gjumi duke ëndëruar
ndonjë kafshatë!

Me lule erdhe, moj pranverë,
por dhe uria po troket në derë!

I lodhur në Kremlin, çdo natë,
Lenini ha pak çaj me bukë thatë!
Kudo uri, uri, —
edhe Ay po vuan me popullin e tij!

Dikush troket në derë
dhe sjell një pako me ushqime.
— «Mos u mundo, të lutem, tjetër herë,
kam sa për vehte time!»
Edhe Iliçi buzëqesh:
— «Kudo më të uritur mund të gjesh!»


Kjo pako udhëton mbas disa ditë, —
do shkojë në shtëpinë e fëmisë, —
me sa gëzim e presin çilimitë!
Në vitin e urisë
si një baba
mendon për 'ta
Lenini!

ZEMRA E LENINIT

Si vetëtimë lajmi shkoi kudo,
arriti deri në llogore
prej ku ushtari-i kuq hero
do të sulmojë deri në fitore.
Kaloi dhe sipër shesheve të nxira
e në çdo fshat të humbur po kumbon:
—»Do gjak Lenini për operacion!«

O çaste të vështira!
Po gjak Leninit kush nuk i dhuron?
U ngrit në këmbë tërë vegjësia:
— «O Lenin, Lenin, merr prej gjakut tim!»!
Sa madhështore rritej dashuria
e popullit për udhëheqsin trim.

Dhe u përhap në botë një jehonë
prej njerëzve të thjeshtë nga çdo anë:
—«Shëroju, shoku Lenin, për lumturinë tonë
dhe për inat të gjith' armiqve tanë.
Kjo zemra jote rrahu për ditët e lirisë
që të shkëlqejë ylli fitimtar,—
në zemrën tënde, zemër e Partisë
rrjedh tërë gjaku revolucionar!«



FLAMURI I KUQ VALON I LIRË...

Lenini rri në shtrat i qetë
dhe ndoshta Komunizmin ëndëron.
Dritarja është çelur, duken retë
dhe një flamur i kuq që po valon.

Armiqtë e plagosën n'errësirë
por asnjë dhmbje më Ay nuk ndjen...
...Vështron flamurin që valon i lirë
dhe pranë tij një yll që po shkëlqen!



XHAKETA E ARNUAR

Dikur xhaketën plumbi e përgjaku
në shpatulën e djathtë dhe në mes.
Iliçi veç xhaketën nuk e flaku
se ia arrnoi Nadjezhda me kujdes.

Kur dilte në oborr për t'u shëtitur
mbas pune, aq i thjeshtë dhe i qetë,
mund të shikonje ku e kish goditur
armiku...

Shënjat ishin mbi xhaketë!

Dhe sot ju shënjat mund që t'i shikoni,—
në muzeum xhaketa po pushon...
...Sikur na flasin arnat: — «Mos harroni
se hasmi prapa shpine na qëllon!»



Lenini i sëmurë
po qëndron
në kabinet të tij.
Në këtë zyrë ndoshta nuk do të hyje kurrë,
këtu për her' të fundit po punon...

Mendon
me sa ushtarë dhe fshatarë
ka biseduar shtruar,—
çdo kënd i ruan një kujtim të paharuar,
një pjesë të pandarë
të zemërës së tij.

Do shkojë që të çlodhet në shtëpi,—
arrin deri në derë,
por kthehet i menduar,—
s'mund të flerë!

Hap një vëllim me ligje,—
i dridhen fletët, s'ka fuqi,
por dhe në çast të fundit po shkruan një
përgjigje
dhe buzëqesh, se ndoshta në agim
diku në botë,
dikush do të gëzohet e do të thotë:
«Mendoj Lenini dhe për hallin tim!»

APASIONATA E BETHOVENIT

Në piano dikush në shtëpi po këndon
në heshtjen e thellë të natës.
Dhe zemra e Tij me guxim fluturon
mbi tingujt e Apasjonatës!

Sot ëndra m'e shtrenjtë u ndez përsëri
në heshtjen e thellë të natës,—
drejt yjeve ngiitet me vrullin e ri
mbi tingujt e Apasjonatës!

Dhe sulme fitoresh Iliçi po ndjen
në heshtjen e thellë të natës, —
pasjoni i zjarrtë për jetën shpërthen
mbi tingujt e Apasjonatës!



POEZIA E JETËS

POEZIA E JETËS!

Ti na pushtove zemrat, poezi,
në ritmin tënd m'e bukur duket jeta.
Na dhe guxim a shpresë në stuhi,
dhe dritë sot shpërndan si e vërteta.

Kur partizani nisej në luftim
i ndeze zemrën me një varg të zjarrtë,
Ish kënga që përhapej si kushtrim
dhe ngjitej gjer në majën më të lartë.

Dëshmorëve që ranë për atdhe
duke kënduar para pushkatimit,
ti poezi, fuqi e vrull u dhe
me ëndrën më të shënjtë të çlirimit.

Sot po të ndjej në sulmin fitimtar
të minatorit tonë të Rubikut, —
në tingujt e një trimit marinar
që i këndon krenar Adriatikut.

Ti rron në fushat tona ku çdo vit
m'i pasur na përkundet bereqeti.
në një fshatar të thjeshtë që u rrit
dhe mjekësi studjon me bursë shteti.

Në një doli fitoresh ti shkëlqen,
në kohën e begatshme që do vijë, —
o poezi, të ndjej se si shpërthen
në çdo betim të pastert aasurije!

Ti na rrëmben ashtu dalengadal
dhe na shëtiti n'epokën atomike.
Ne ëndërojmë shi artificjal
dhe grurë afër zonave Artike!

Me ty i ndejmë pranë shekujt kur
dhe jeta jonë shpejt ka për t'u zgjatur,
kur s'do të kemi veç se një flamur,
zotër të hapësirës së pamatur!



SKËNDER PO FLAS ME TY...

Kthehem në shtëpi duke menduar
vargje pranverore! Ja, po ndjej
ritmin, ritmin që më ka pushtuar
dhe më rend me gjakun nëpër dej.

Erdhën dallëndyshet bisht-gërshëra,
çajnë hapësirën pakufi.
Ec ngadal. Dëgjoj në qoshe zëra:
qeshuni, o qeshuni fëmi!

Midis tyre përshëndes një djalë,
i jap dorën, e vështroj në sy.
Një kujtim më zbret dalengadalë,
një kujtim Skënderi im për ty!

Ty të lindën vitet e stuhisë, —
s'i mban mënd, por unë i kujtoj.
Nuk e puthe nënën, s'të dha sisë,
humbe prindët, ranë si heroj!

Si kaluat ju, o vite, vite,
ëmbël përkëdhelet një fëmi.
Po hedh shtat Skënder! Skënder u rrite,
pranë të qëndroi nëna Parti!

Dhe kur ti më qesh plot gaz e dritë
ndjej të ardhmen, kohën si troket, —
të mendoj me dashuri, një ditë,
inxhinjer, doktor, ndoshta poet!

SHTËPIA E RRËNUAR

Po shëmbin rrugës një shtëpi
dhe shëtitorja udhën çan krenare
Ndërtesa mbeti pa çati,
të verbëra më duken dhe muret pa dritare.
Kaloj andej çdo ditë
dhe si çudi më duket shtëpia e rrënuar.
Shikoj ballkonin e rrëzuar
ku loznin dje fëmitë
dhe hekurat që mbetën të zgjatura si duar.

Po shëmbin rrugës një shtëpi, —
qyteti zbukurohet me kopshte dhe çatira.
Dy mure kanë mbetur ... Në këtë qoshe rri
ku duket mes gërmadhash hapësira.
Mendoj këtu:

«Rrëzohet një shtëpi
por jo nga bombardimet.
... Sa tmerr do t'ish sikur këtu rrënimet
të kishin hije vdekje përsëri.

... Ashtu gërmadhë do të ish shtëpia,
mbytur në gjak do dergjesh fëmia,
do zgjateshin doçkat e ngrira
si hekurat e mureve të nxira.
Dhe ndonjë nënë, rrugës, e verbuar,
si muret pa dritare në çaste bombardimi, —
më kot do bridhte ditën, në terr, si e hutuar,
t'i lante plagët foshnjes me lotë dëshpërimi!

HEROI NË TIMON

Drejt kreshtës po ngjitet përpjetë makina,
i heshtur, shoferi qëndron në timon.
Dy çape më tutje zgjat krahët gremina
e ftohtë, e zezë, e frikshme si hon.
Dhe bredhat sikur po vërtiten në kthesa,
mbarim s'paska rruga në mal, —
me ëndra, me halle, gëzime dhe shpresa
po ngjitet makina ngadal.

Një vajzë mendon se atje në bregdet
ku çelin limoj, portokale,
i dashuri rrugës me mal po e pret,
vështrimin e tret nëpër male.
Një dja'ë me çantë po shkon me shërbim, —
s'ka shkelur këndeje ndonjë herë.
Ky deti i kaltër i duket qilim,
Dhjetori i duket pranverë!

Po qeshin këtu dhe ushtarë,
këthehen me leje në fshat përsëri, —
këndojnë se malli ata i ka marë
për kodrat nga brodhën kur ishin fëmi.
Në fund të makinës një plakë po qan,
dhe era po fryn nëpër drurë.
Oh, letrën e djalit në gji po e mban, —
i shkruan se dergjet sëmurë...

Arriti makina në majën e malit,
bregdeti këndeje duket krejt,
atje pas bregores rreh zemra e djalit...

«shofer, — mendon nëna, — më shpejt, shko
më shpejt!»

Por anash e rreptë vërsulet gremina
dhe rrotat nën gurë tronditen me tmerr.
Një hap i gabuar dhe bije makina,
shoferi, të duket, as frymë nuk mer...

Me muskujt tendosur, me syt'e gozhduar
shtrëngon fort timonin në kthesa dhe zbret...
... Sa herë me vdekjen si trim ka luftuar
njeriu i thjeshtë që rron në bregdet.
Dhe dimrit të egër ay në shtërgatë
kalon i patrembur këndej me zinxhirë,
kalon ditë e natë
në mes të dëborës, në rrugën e ngrirë!
... Sa shpresa arritën në mes të stuhisë,
sa ëndra shëtitën mbi male gjer von, —
sa zemra kënduan në prak të shtëpisë
se rri një hero në timon!



KËTTHEHEN PUNËTORËT NË SHTËPI

Këthehen punëtorët në shtëpi.
Sa veta po kalojnë tej mureve të mija?
Kam dalë në dritare përsëri
dhe buzëqesh i lumtur si fëmia.
Do çelen dyer... Dhomat do mbushen plot me dritë.
e perdet do valviten nëpër erë.
Prej çerdheve do kthehen çilimitë
si dallëndyshet në pranverë.
Gëzim do ketë, mall e rreze-drite, —
e ndonjë prind në gjoks, me përmallim
do të pushtojë foshnjen:
— «Sa m'u rrite,
o bir i babit, ti o shpirti im!»

* * *

Këthehen punëtorët në shtëpi
dhe kuvëndojnë...

Më pëlqen kjo zhurmë!
Në këtë çast të ëmbël mar fuqi
se zbret dhe zemra ime n'atë turmë.
Të lodhur ndoshta janë, por ecin aq të qetë, —
në çdo vështrim lexoj
një dashuri të fortë, një mall për këtë jetë
ku rriten në beteja të thjeshtë si heroj!
Ndokush e ka këmishën të arnuar,
xhaketën pak të zbardhur, por kalon
me ballin lart!

Nderoji këto duar
të ashpra e të nxira,
përpara tyre tretet errësira
dhe Socjalizmi fitimtar marshon!

O RRUGË MALI!

Mirë se të gjej rrugë malore,
oh me sa mall të përshëndes.
Zhurmojnë pyjet shekullore,
këndon gjinkalla që po vdes.

Ti ngjitesh lart, më lart ndër kreshta,
me vrull përoji tutje zbret.
Përpara teje sonte heshta,
dëgjova zemrën si troket.

Në prag të derës del një plakë,
vështron e heshtur edhe tjerr.
Del një çobankë... Ndalun pakë,
po ti me vehte po na merr,

dhe tutje-tutje po na shpije,
ku një shqiponjë fluturon,
ku duket Drini si një vijë,
lart ku poeti ëndëron.

Po ngjitemi në hije e dritë
se djelli zbret në perëndim,
Vrapojnë udhës çilimitë
dhe brohorasin me gëzim.

Të dashuroj, rrugë malore,
me ura druri në çdo shteg,
dhe me shkëmbenj si përmëndore
që lartësohen breg më breg.

Mistere ruan çdo greminë
se vdekja ndeshet si në front.
Çdo kthesë ruan bukurinë
dhe poezi çdo horizont!

Po zbardh në majë një kasolle
në mes të shkëmbit pambarim...
Mur feudalësh, ti më dolle
përpara por si një vegim.

Këputi qafën Bajraktari,
dhe kokë-ulur mbete ti.
Nga larg më dukesh si mur-varri
që sot po dergjet në vetmi.

Sa ëmbël fryn këtu zefiri
dhe reja velon shpesh e gris
lart, mbi një kreshtë bojë hiri
ku rrënjët hedh krenar një lis.

Rizgjohen ëndërra rinije
kur lemë pas çdo gur, çdo dru.
Vallzojnë anash fije — fije,
marshon tensjoni i lart këtu.

E rendin dhinë me këmborë,
me 'to në zall po rend jehona.
Zbardhojnë kreshtat me dëborë
të bardha por si zemrat tona.

Mirë se të gjej o rrugë mali,
m'e shtrenjtë po më dukesh ti.
Na lartëson si ideali,
si dashuria në rini!

Në rrugën Kukës-Peshkopi.

SHËNIMET POLITIKE

I ulur mbi një gur anës xhadesë
po prisnja kamjonin për Tiranë
si udhëtar mësuar që të presë.
Ish vjeshtë, edhe bari kishte vesë,
dhe lumi pa u lodhur ecte pranë.

Si rrinja duke parë tutje retë
më tej, avitej rrugës me ngadalë
një minator i lodhur por i qetë.
Lexonte me vëmëndje një gazetë
dhe ndoshta bëlbëzonte ndonjë fjalë.

Ky malësor nga bjeshkat e Tropojës
që flinte në ahur me bagëtitë
dhe deri dje nuk kish bukën e gojës
rritur në terr dhe me frikën e Zojës, —
ecte krenar në rrugën plot me dritë!

Kur erdhi pranë meje, tek kalonte,
e pashë se kish rënë në mendime...
«Shënimet politike» po lexonte...
N'atë vështrim malsori po mallkonte
ata që ëndërojnë bombardime!

Ata që duan prapë bajraktarë,
të ketë përsëri jastëk një gur, —
të endet i uritur si më parë
dhe foshnjat t'i dëgjojë duke qarë
për misër, për pak misër si dikur!


NË PARAKALIM

Im bir, Iliri është dy vjeçar
dhe me gëzim të madh po pret të dalë.
E marr në krah dhe rrugës jam krenar
se kam dhe unë më 1 Maj një djalë.

Blerime, këngë flamuj dhe rini, —
çdo gjë më qesh e më pushton gëzimi.
Me shokët u bashkuam... Ja, tani
fillon mbas pak këtu parakalimi.

Marshojmë drejt, përpara, të bashkuar,
na gjen 1 Maji më të fort' se kurrë.
Kështu i lumtur duke ëndëruar
shikoj tim bir të rritur, bërë burrë!

Mendimi bredh dhe koha fluturon, —
më njomen sytë, jam i mallëngjyer.
Sikur e shoh, krenar parakalon
dhe me të shtatin pesvjeçar të kryer!



LUMTURIA

— 1 —

Përoji rrjedh e rrjedh me gurgullime
sikur i shpreh natyrës dashuri.
Spitali fle me dhimbje dhe gëzime,
mbas pak do lindë djelli përsëri.

Në qjell filluan të rallohen yjet
dhe hëna vetëm udhëton ngadal.
Për rreth po zgjohen kodrat edhe pyjet,
ndriçohen kreshtat atje lart në mal.

Të parat rreze derdhen në dritare,
përtej po duken dallëndyshtet varg, —
dhe fryn këtu një erë bregdetare
që të kujton se deti s'është larg.

Agimi shikon orën i mërzitur,
agoi një tjetër ditë përsëri.
... Kur asnjeri ti s'je më duke pritur
të duket se në botë s'ka njeri!

Vështron me mall e dhimbje të pashuar
dy sy të ëmbël, dy sy tërë nur.
Fotografinë po e mban ndër duar
dhe Bardha buzëqesh por si dikur.

Sa ëndra kishte thurrur dhe sa shpresa
po lulëzonin në një shpirt jetim.
I duken se u tretën por si vesa
që zhduket përmbi lule në agim!

Dhe ndjen një peshë që e lodh përherë
sikur mbi supe tërë qjellin mban,
S'ka asnjëri!

Pranverë, moj pranverë,
me njerëzit ti vuajtjet i ndan...

Përkund një degë bliri, treti retë,
një copë qjell të kaltër sill këtu.
... Le të këndojë era nëpër fletë
një këngë që dëgjoi ay diku.

E ëmbël ishte Bardha dhe e bukur,
nga pas i mblidhte flokët me kordel.
Dhe sot ashtu çdo natë i është dukur
kur qe nga larg përpara po i del.

Kujtimet koha s'mund që t'i humbasë
se pesë vjet studjuan që të dy,
dhe çdo mëngjez po hynin tok në klasë,
dhe çdo mëngjez shikoheshin në sy.

Sa herë panë hënën duke dalë
kur afër lumit putheshin me afsh,
dhe kur ajo si theshte asnjë fjalë
i përkëdhelte flokët si mëndafsh.

Por Bardha vdiq dhe larg ka mbetur varri, -
u ndanë përgjithmonë me trishtim.
Atje tani po dridhen fije bari
kur djelli tretet tej në perëndim.

- 2 -

Kaluan disa ditë pakuptuar
si po kalon mëngjezi pranveror:
... S'ka asnjë javë që kur ka filluar
shërbimin në spital, porsì doktor.

Doktor në një spital me dhjetë shtrate,
në një qytet të vogël, pa njeri.
Kish ëndëruar salla dhe pallate,
(sa shumë ëndërojmë në rini!)

Pasdreke ndërsa rrinte i menduar
e thirrën shpejt dhe zbriti përsëri.
Një vajzë prej një shkëmbit ish rrëzuar,
nga larg mbi kalë e pruri një i ri.

E zbehtë në fytyrë, por e bukur, —
një thirrje dhimbje, heshtje... dhe pastaj
si Bardha për një çast i ishte dukur...
Agimi mbeti shtang përpara saj!

Dy kaçurrela ballin ia lëmonin,
dhe ajo flinte, flinte në spital.
Bilbilat në dritare po këndonin,
ndoshta për 'të këndonin me aq mall!

E bukur ishte vajza dhe ish rritur
lëndinave kur dilte çdo agim.
Dhe dukej, tek po rrinte e veçantë
si një kaproll që çlodhet në burim!

Ish në rrezik kjo vajzë si pranverë,
ish në rrezik dhe mund të ishte von.
Agimi do fillonte me një herë
me ankth të madh këtë operacion.

Me vdekjen do luftonte pamëshirë, —
i dukej se dëgjonte një kushtrim.
Po e thërriste jeta jonë e lirë
të hidheshe në luftë me guxim!

Ky ish i pari operacion në jetë, —
e ndjente se do dilte fitimtar.
Pra jeta s'ish e kotë dhe e zbehtë,
ajo nuk mund të ndrydhej në një varr!

— «Shoku doktor, a thua do shpëtojë?
Do ma shpëtosh, doktor? Do ma shpëtosh?»
Me sy të njomë ju përgjegj: — «Do rrojë!
Të lumtur do jetoni, o djalosh!»

Ajo kish humbur tepër gjak më parë, —
operacioni niste, ja, mbas pak.
Me sy të humbur dukej si e vrrarë, —
i duhej gjak, po kush t'i jepte gjak?

Agimi e vendosi: ay vetë
do t'i dhurojë gjak...

Dhe gjaku rrjedh!
Po fryn një fllad dhe lart po shtyhen retë
dhe pjeshka në dritare lot një gjeth.

Përroji rend me vrull se erdh pranvera
me këngë dhe me puthje në mullar...
Dhe fushave po rendin tufa shqera,
dhe gjaku rend ndër deje fitimtar!

— 3 —

Po niset vajza. Ikën e shëruar!
Sa ditë e bukur! Gonxhe, lule, Maj!
I dashuri e puth i përmaaluar, —
s'ka gjë se mbrëmja zbret pak më pastaj...

— «U trashëgofshi pra! Udhë të mbarë!»
Një çift i lumtur shtegut po humbet,
edhe Agimi ndjen për her' të parë
si krahërori i tij buçet... buçet...

Shpërthen një këngë jete, përmallimi
që përqafton natyrën me gëzim.
Dhe tinguj shprese tërë njerëzimi
doktorit i dërgon si një urim...

Ka shkuar tutje çifti, s'po dallohet,
por mbeti jeta, jeta që buron, —
dhe ajo vlen me zjarr të dashurohet,
çdo ditë të jetohej me pasjon!

— 1957 —



TE ÇEZMA E VASHAVE TË BUKURA

Butrinti ëndëron rreth kodrës shtrirë,
në djell shkëlqejnë gurët si dikur.
Në këtë skaj të lashtë kam dëshirë
të prek çdo shkallë, çdo kolonë e mur.

Avitem pranë çezmës ku më parë
vraponin lehtë vashat çdo agim
t'i mbushnin stomnat, sytë për t'i larë
dhe të këndonin: «Eja shpirtim im!»

Qëndroj në vënd. Mendoj si shkuan vitet
dhe më vjen keq të shkel mbi këtë bar,
se vashat s'janë më dhe bari rritet
prej dheut ku çdo vashë fle në varr.

Më duket se shikoj gjurmat e çdukura
mbi lulet që për rreth po rriten.
Legjoj zërat e vashave të bukura
që çezmës i aviten!



U SHOJT NJË YLL!

— (Poeti i Rinisë), —

Pak dritë! Pak dritë! Pak dritë, o shok, o vlla!»

.....

Nata kalon

dhe gjumë s'ka...

Një shekull duket nata kur sytë s'i mbyll dot.

I zihet fryma, vuan sikur e mbyt shtërgata

dhe as prej shtratit s'lot.

Diçka i dhemb, ç'i dhemb s'e di,—

po vdes,

dhe pranë s'ka njeri!

Dhimbje krenare,

shpejt ke zbritur

mundon një zemër në rini!

Është i ri!

Jeta agon,—

m'e bukur del se kurdoherë.

Zemra i rreh,

e ndjen,

shpreson,—

jo,

s'mund të vdesë në pranverë

se jeta lulëzon!

* * *

Senatoriumi fle i qetë
kur vdekja,

ja
trokiti.
Në dhe të huaj dergjet...

Është viti

1938!

—« Ç'po ngjet kështu?»

—«Po vdes shqiptari!

Disa minuta dhe mbaron!
Rend infermjerja shpejt...

Kruset...

Jeton,

ngadal po shuhet zjarri!
Dhe flet përçart!

Kush s'e kupton,—

e dashura në gjoks po e shtrëngon,—
edhe e ëma erdhi pranë tij...

...Ç'mendon, Migjen i shtrënjtë, ç'ëndëron
i humbur n'agoni?

.....

Dritarja po zmadhohet... N'errësirë
rëshqasin yje... Tinguj, dritë e hije...
Po ndjen si fluturon me hov rinije, —
dallgët buçasin...

Si një zog i lirë
në Shqipëri

i lumtur

poshtë zbrët.

Lule,

fëmi,

malsorë të gëzuar,
atdheun puth së largu një poet!

Besimi se kjo tokë e lirë do të jetë
i jep fuqi ta shohë dhe vitet kapërxen.
Në këtë çast të fundit vështron një tjetër jetë,
po vdes me gaz në buzë i dashuri Migjen!
Zemra, zemra e lodhur i mbledh tërë fuqitë,—
këndojnë çlirimtarët,

një popull e thërret!
Fitorja zbret nga mali, agon një tjetër ditë,
poeti duke vdekur lirinë përshëndet.
Dy sy të tretur n'agoni ndriçojnë, —
kërkon të ngreje kokën,

s'ka fuqi,—
as dorën s'e lëviz...
... Ata këndojnë...

«Gëzoju Shqipëri!

Liri!

Liri!»

Me lot' ndër sy me shokët përqafohet,—
natyrë, o natyrë,
po shuhen dritat,
tingujt, errësohet,—
i ngriu e fundit buzëqeshje në fytyrë!

.....

Lulet e verës ulën leht'petalet,
me lotë vese e qau trandafili,
rënkuan pyjet, heshti dhe bilbili,
u mpinë dallgët, psherëtitën malet,—
se ra një yll në qejt e Shqipërisë,
u shojt një Yll,

Poeti i Rinisë!

BUZËQESHJA

Një bir malsori erdhi ndaj t'aguar,
në këmbë rri te varri yt, Migjen.
A e shikon? Qëndron kokë-zbuluar,—
ndër kaçurrela rrezja i shkëlqen.

Ti nuk e njeh këtë malsor të mitur,
dhe as ay s'të pa në ndonjë vënd.
Por ja, **Lulin e vocërr** ka lëçitur
dhe erdhi si një mik mbi varrin tënd.

Sa fjalë t'ëmbra do që të të thotë,
por s'di a i dëgjon ndën lapidar.
Mendon që të mos kesh atje të ftohtë,
ngadal dëborën ta pastron mbi varr!

Përkulet dhe vështron fotografinë, —
në sytë e njomë ndizet një shkëndi
dhe buzëqesh!

, Ti pranë ke fëminë,—
Migjen, e ndejn si rreh zemra e tij?

DRITË NE KATUND

ÇLODHJA

Ndën shkëmbin e madh dhe të nxirrë
po ndizet një zjarr partizan.
Kur theken rreth prushit, të shtrirë,
natyra në prehër i mban.

Në trasta pak bukë ka mbetur
në fund, kushedi se që kur...
E ndajnë... Dikush sa ka fjetur
me kokën mbështetur mbi gur!

Lind djelli dhe larg skuqen retë
prej rrezeve t'arta n'agim, —
edhe era këndon nëpër fletë
një marsh partizan pambarim!



MBI VARRIN E NËNËS

Shtëpitë për tokë, me radhë,
shpërndahet larg tymi i zi,—
i tërë katundi gërmadhë,
të vrara dhe foshnjat në gji...

Atje shtrihej anës oborri,
shtëpia këtu ish dikur,
por shkeli mbi 'të gjakësori
dhe s'mbeti në këmbë një gur.

Fillon të gërmoje. Ngre gurë,
ngre trarë në heshtje ai.
Në luftë s'u drodh trimi kurrë,
por krahët i dridhen tani.

Një dorë me grushtin e mbledhur,
e nxirë, mbështetur në bel.
Përsipër një tra është hedhur,
kufoma e nënës po del...

Dhe zgavrat i duken humnera,
rrënimet mbajn' erë barot.
Ndër flokët e nënës fryn era
dhe fijet e bardha i lot!


«O vjeshtë, mbaj mënd o ti vjeshtë
dhe lotët, dhe sulmin barbar!
Urrejtja s'do mund që të heshtë,
për jetën do ndizet me zjarr!»

Kalon me fytyrë të tretur,
me dhimbje sot nënën e mban.
Fytyrën e saj' ka mbështetur
në zemër, ta ndjeje si qan...

Kalon i tronditur mes shkrumit,
derdh lotë ky trim luftëtar.
Qendron të një plep pranë lumit,
dhe ulet të hapë një varr.

Mashinkën e ngre i tronditur,—
mbi varrin e nënës po rri.
Ndjen zemrën në gjoks të cfilitur
por grushtat shtrëngon me fuqi.

Mbi varrin e nënës, i tretur
prej dhimbjes në gjunjë nuk ra.
Në çastin e hidhur ka gjetur
guxim për betejat e ra!



« HAKMARRJA »

Tërhiqen ballistët papritur,
«Hakmarrja» arriti në pyll.
Fryn era dhe shkrumin ka ngritur,
hedh dritë së largu një yll!

Oh, fshati i shtrënjtë po digjet,
lujina me zjarre u mbush.
Në terr po ndriçojnë dhe brigjet
dhe qjelli po skuqet si prush.

Arriti «Hakmarrja», arriti
bregoret dhe shtigjet rrethon,—
dhe fshati prej bombash buçiti,
një çetë mes zjarrit sulmon.

Xhelatët shtrëngohen në darë.
rrethimi ngushtohet sa vjen.
Katundi po digjet i vrarë
por qjelli i skuqur shkëlqen!



PËRPARA PUSHKATIMIT

Një djalë dhe një vajzë po ngjiten ndaj agimit, të heshtur po vështrojnë natyrën me guxim. Me ballin lart qëndrojnë përpara pushkatimit dhe sytë-e tyre treten në qjellin pambarim..

— «Pra flisni, ku i gjetët ju traktet e Partisë!» xhelati shtrëngon dhëmbët me kërcënim barbar. Po fryn një filad i lehtë dhe lulet e qershisë u shkunden përmbi supe, rrëshqasin dhe në varr...

...Dy ryma gjaku rrodhën, u skuq e dlipta vesë dhe zogjtë fluturuan, nuk ndihet cicërim. Të dy të rinjtë ranë si lisi prej rrufesë, e dukeshin se tokën e puthnin me nderim!



ME 7 NËNDOR !

Po ngriheshin në rrugë barikada,
shkëlqenin yje dhe ndriçonin zjarre.
Me një gjerdhan, me bomba dhe granada
krenare ish Tirana luftëtare!

Në një shtëpi të unjtër ishin shtruar
disa nga partizanët e plagosur.
Armiku po qëlonte papushuar
dhe qjelli natën dukej i gjakosur.

Larg njëqind metra ish fortifikata,
nazistët t'egërsuar villnin zjarr.
Më 6 Nëntor, aty, kur zbriti nata
i mblodhi trimat shoku komisar.

Fortinën do sulmonin ndaj agimit
dhe më të lehtë e ndjente krahërorin.
Sa fort i rrihte zemra prej gëzimit:
—«Festojmë, shokë, nesër 7 Nëntorin!»

Fryn flladi i Tetorit, fllad liriye,
na sjell nga Moska paqen, lumturinë.
Le ta festojmë pra siç na ka hije,
o shokë, mbushni shishet me benzinë!»

* * *

Të nesërmen, pa zbardhur ende dita
kur mjergulla në rrugë ish shpërndarë,
në qetësi, një skuadër djem-petrita,
ngadal armikut i avitej zvarrë!

I rreptë shpërtheu sulmi nga çdo anë,
atje nazistët mbetën brënda honit.
Të papërkukur, trimat partizanë
festonin ditën e Revolucionit!

Nuk i ndalonte dot asnjë pengesë,—
u hodhën përmbi tela me guxim.
E kush mendon se nesër mund të vdesë
kur Djelli lind i qeshur në agim?

Mes predhave ushtoi një zë: — «Urra!»
ish zëri i fitores, i çlirimit.

Por ah, një plumb në zemër drejt i ra,
dhe e rëxoi në ballë të luftimit.

Me gjak e njomi tokën komisari, —
agonte dhe një qjell po zhdukej hëna.
Lufta vazhdoi. U ndez m'i ashpër zjarri,—
më 7 Nëntor dëgjoheshin të shtëna!

Dhe duke mbyllur sytë përgjithmonë
mbi këmbëzën e pushkës i ngriu dora.
...Ju duk sikur dëgjonte si jehonë
të shtënat e kryqzorit Aurora!



PRITJA

— 1 —

Kur burri i dolli në male komit,
i mbeti e varfër shtëpia.
Në dhomën e nxirë, mban mënd, atë vit
s'kish bukë kur lindi fëmia.

Ish dimër i ashpër dhe s'kishte njeri,
dhe foshnja i flinte urritur.
Sa nete të gjata kaloi në vetmi
të shoqin me ankth duke pritur.

Çdo çast i kaluar i ngjall një kujtim, —
sa nete, sa nete pa hënë,
mbi djepin e varfër, atje në mjerim,
ka ndenjtur e krusur kjo nënë.

Në gjumë dëgjonte. «Oh mos më harro!»
dhe nusja vazhdonte të presë,
Do kthehej një ditë komiti... Ajo
e priste me mall dhe me shpresë.

—2—

Filluan të kthehen komitet në fshat
dhe nusët u dilnin ndër ara.
Me foshnjën e dobët dhe nusja pafat
më kot kishte dalë përpara.

S'u kthye me shokët ky trimi komit,
s'trokiti, si shokët, në derë,
I theshnin komshitë — Ti kot mos e prit,
s'do kthehet tani asnjëherë!»

Por nusja me foshnjën e dobët në gji
vështronte drejt portës, e mpirë,
Dhe priste të hynte ai përsëri,
t'i theshte një fjalë të mirë...

T'i qeshte së paku një herë, pastaj
të zhdukej në terrin e natës..
T'i theshte: — «E dashur tani mos më qaj
se roj përmbi kraht e shtërgatës!»

Dhe nëna me flokët e bardha, argjënd,
prej derës s'e hikte shikimin.
Atje, mbi rrogzin e vjetër, në kënd,
në heshtje, me mall priste trimin.

— 3 —

Një ditë kur qjelli u nxi me tufan
dhe lulja u shkel në lëndinë,
djaloshi me shokët u nis partizan
ta mbronte ndër bjeshka lirinë.

Dhe nëna dëgjonte një zë: «—O nëno!»
Jo, kurrë ky zë s'do të vdesë.
Do kthehej një ditë i biri... Ajo
e priste me mall e me shpresë.

... Një këngë fitorje prej malit kumbon,
këndojnë sot zemrat e lira,
Prej Lindjes një ditë e lumtur agon
mbi kopshtet dhe vatrat e nxira.

Me mall përqafohen... Oh, loti të flet
për vuajtjet, ngricën, urinë,
për ëndrat, për popullin tonë poet
që sheh mes gërmadhash lirinë!

Filluan të kthehen të rinjtë në fshat,
dhe gratë u dalin ndër ara.
U nis edhe nëna të ngitet në shpat,
t'i dalë të birit përpara.

Ylberi ka zbritur kurorë mbi mal
dhe mjergulla nisi të tretet.
E lodhur, përpara po ngjitet ngadal,
po nëna në vënd shtang pse mbetet?

Me yllin në ballë vjen djali azgan,
të birin më kot nuk e priti.
Së bashku me djalin e saj' partizan
i duket se erdh dhe komiti!



KËTHEU BABA I DASHUR....

— 1945 —

Kam mbetur sonte vetëm në shtëpi
dhe asnjëri
s'po më shikon kur shkruaj.
Pse nuk këthehesh përsëri,
baba i shtrenjtë, pse më le të vuaj?

E vogël jam dhe mbeta në dritare,—
të pres me mall në gjoks të më shtrëngosh.
Dikur më le të vogël fare,
si mundet vallë ti të më harrosh?

Të tjerët partizanë janë kthyer,
po ti përse vonohesh, shpirt o xhan?
Pse nëna po vështron e mallëngjyer
fotografinë tënde dhe po qan?

Pse nëna mban tani një shall të zi,
pse buzëqeshja i mungon shtëpisë?
U kthyen dallëndyshet përsëri,
po shkunden edhe lulet e qershisë.

Një vjershë aq të bukur e plot dritë
për luftën partizane kam mësuar.
Të pres baba, të më dëgjosh një ditë,
të më pushtosh me mallin e pushuar!

DRITË NË KATUND

I tërë katundi fitoren feston,
po lozin në rrugë fëmitë.
—«Erdh drita! Erdhi drita!» — çdo zemër këndon,
lugina po mbushet me dritë.

Një ish partizan në dritare po rri,
dëgjon si qesh foshnja dhe plaku,
mendon se këtu doli tymi i zi
kur hidhej në flakë njomzaku.

Luginën e dashur mes zjarresh e pa
kur bandat balliste i mundi,
kur erdh tradhëtari dhe nëna u vra,
kur digej i tërë katundi.

... Dhe ja, sonte fshati ndriçon përsëri,
shkëlqen sonte prapë shtëpia,
por njerëzit qeshin të lumtur tani
se dritën e pruri Partia!



I PENDUARI

Një udhëtar i heshtur, i menduar,
si hije po këthehet në shtëpi.
Sa shpresa larg atdheut janë shuar,
sa vite kanë shkuar n'arrati!

I lodhur natën shtigjeve ka ardhur,—
në dhe të huaj rruga s'kish mbarim.
E krusën vitet... Flokët janë zbardhur,
edhe u mplak, u mplak në perëndim!

Po ndjen përbrenda se e bren pendimi
për vitet që ju tretën pak nga pak
në arrati, në kampe përqendrimi,
me krerë, me dollarë dhe farmak.

Mban mënd i raskapitur atë ditë
kur zbritën partizanët... Ish Nëndor!
Braktisi gruan, nënën dhe fëmitë,
u fsheh në dhe të huaj si fajtor.

Do deshte ta harronte të përpjetën
me vuajtje dhe lotë në mërgim.
Po sjell ndërmend papritur tërë jetën
që por si hije shkoi, si një trishtim...


Do deshte që ta flakte në harresë,
të treteshe si shkuma në bregdet,
se iu gremis pa dashuri, pa shpresë,
si një qivur që zbret, në varr humbet...

»Do jetë rritur vajza lozonjare,
dhe këtë vdekur nëna kushedi,—
dhe gruaja do jetë thinjur fare,
pa shpresë, pa gëzime në të ri!»

Qëndron në vënd i heshtur... Ka arritur,
ja, porta e oborrit pak më tej.
Rrugica po i duket më e ndritur
dhe të dy plepat shumë të mbëdhej.

Por si më parë zogjtë janë kthyer,
dhe si më parë tutje shkon një re, —
me gjithë atë vështron i mallëngjyer:
këtu për rreth çdo gjë i del e re!

Hedh çapet me ngadale, i dërmuar,
sikur s'ka pikë gjak, i verdhë dyll.
Atdheut armët i ka dorëzuar,
çel portën kokë-ulur dhe e mbyll!



NE RRUGEN E JETËS

DO KTHEHEN DALLËNDYSHET DHE PËR TY

Dikur të pashë të gëzuar,
e lumtur ishe ti...
Kalonje rrugës duke ëndëruar
të parën dashuri.
Ti iknje si sorkadhja nëpër pyje
dhe sytë e tu shkëlqenin si dy yje...

Të dashurin at'here kishe pranë,—
e pastërt ishe ti si një agim...
...Por lulet tepër shpejt u thanë,
dhe kokë-ulur çdukesh me trishtim...
Dëbora shpirtin tënd ta ka mbuluar,
shkëlqim as djelli s'ka.
Ti qan e dëshpëruar:
i dashuri ka ikur e të la.
Për ty sot nata yje s'ka, as hënë,
as bota dashuri,—
së shpejti do jesh nënë
dhe pranë s'ke njeri!

Por mos mallko rininë
dhe mbaje kokën lart,
Beso në dashurinë
si një artist në art.
Ti je e re, e freskët si një krua,—
oh fshihi lotët, ngreji ata sy...
...Në jetë do dëgjosh një zë: —«Të dua!»
do kthehen dallëndyshet dhe për ty!



DJALI I TYRE

Dikur ata me neveri u ndanë,
larg shkuan që të dy në dy drejtime,
dhe foshnja e braktisur, si jetime,
s'e puthi çdo mëngjez me mall babanë.

Tani në jetë foshnjes s'i ka mbetur
veç manushaqet, djelli, yjet, hëna,
një pushkë druri e vjetër edhe nëna...
Në gjoks të nënës foshnja rri mbështetur.

Kalojnë retë, shkon dhe hëna e plotë,
kalojnë netët dhe kalojnë vitet.
Pa buzëqeshje foshnjëza po rritet,
ashtu, me psherëtime dhe me lotë..

Se nëna këtë dimër u martua
dhe oh sa shpejt, sa shpejt u ftoh shtëpia.
Me kokën nën jorgan po qan fëmia
kur e godet: — «S'je babi, nuk të dua!»

Tani në krah me mall e ledhatime
askush të shkretën foshnje nuk e mori,
i heshtur ka dremitur dhe oborri
dhe muret duken si disa rrënime.

Në mur, atje dhe pushka mbeti-e shkretë,
e varur, e pluhrosur, e haruar,
se foshnja një mëngjez, e dëshpëruar,
u nis që ta kërkoje babën vetë...

Por edhe babi s'është si një herë
se u martua... Njerkën e ka pranë...
Dhe foshnja nuk e puth më dot babanë,
sot babi përkëdhel fëmi të tjerë!

Sa shpejt «jetim», sa shpejt «jetim» i thonë,—
pa prindër dhimbja oh sa shpejt e rriti
...Por jeta s'e shqelmoi, më lart e ngriti,—
njeri e bëri jeta, jeta jonë!

Doktor do dalë, po mëson dhe rritet
i fortë dhe i bukur dhe i zgjuar.
Prindët kujton me dhimbjen e pashuar,
po i kujton ndërsa kalojnë vitet...

Dhe ndonjë natë mbushur plot kujtime,
i thirrur ndoshta mjeku do vrapojë
prej thonjëve të vdekjes të shpëtojë
ata që e braktisën për dëfrime!



NJË DITË

Mendoj i lumtur ditën kur do të zbresë nata
dhe do na gjeje bashkë të dy ndën një çati.
Një natë dimri... Jashtë po ulërin shtërgata,
në dhomë, pranë teje, gëzim e qetësi!

Më del përpara dhoma e vogël por e qeshur
ku ti thurr një fanellë dhe syt'ulur i mban.
Me një fustan të thjeshtë përbrënda rri e veshur,
por dukesh aq e bukur mbështetur në divan!

Në tavolinën time të punës rri dhe shkruaj
se ëndrat më të ëmbla më falin frymëzim.
Ne foshnjen po e presim... Na vjen mbas disa muaj
të na ndriçoje dhomën me sytë plot shkëlqim!

Më von i lodhur ngrihem, dhe ulem pranë teje...
Ty të ka zënë gjumi por shtizat i shtrëngon...
Të puth ngadal në buzë dhe ndjej se si ndër deje
rrend afshi i lumturisë që zemrën ma pushton!



QËNDRO NJË ÇAST, E DASHUR...

Qëndro një çast, e dashur, se deti na thërret,
tallazet shkumbëzohen, përplasen në bregdet.

Vështro nga perëndimi ku retë ndezën zjarrin,
drejt bregut shkojnë gratë, përcjel'in peshkatarin.


Shiko se si po niset, dëgjohet një lopatë,—
atë s'e tremb as vdekja që fshihet në shtërgatë.

Vërsulet në furtunë dhe zhytet larg në det,
por vajza vështron qjellin, të dashurin e pret.

Dhe zemra i tronditet si barka në stuhi
kur zbret një re e zezë mbi detin ngjyrë-hi!

Qëndron e papërkulur, në breg si një statujë,
mbyll sytë dhe i duket sikur lundron mbi ujë,


ku dallgët çan një barkë, me vrull, në tramundanë,
atje, në mes rrezikut, atje i ndihet pranë!



NË RRUGËN E JETËS

Shëtis me ty i lumtur... Po shëtis
dhe tokën nuk e ndjej kur e përkas.
Fytyra jote dritë-e shënd-e gas
më jep fuqi dhe jetën ma stolis.

Shëtis me ty, shkoj kodrave përpjetë
dhe them me vehte: «Ja çapet e para...
E gjatë është udha... Ne përpara
do ecim krah për krah kudo në jetë!»



TË DASHUROJ

Kur kokën ç'odh mbi supin tim
dhe më vështron e qetë,
duart t'i puth, e ndjej gëzim
si s'ndjeva kur' në jetë!

Sikur të rrijmë ashtu një mot,
një jetë të bashkuar!
. .T'i dua sytë dritë-plot,
t'i dua këto duar!



VARGJE PËR FOSHNJEN TIME

Për ty i shkruaj vargjet, foshnja ime,
që t'i lexosh një ditë...
Gjer sot të pashë vetëm n'ëndërrime!

N'oborr, rreth meje bredhin çilimitë
dhe po mendoj se nesër edhe ti
do lozësh si këta.
Dhe kur i lodhur do këthehem në shtëpi
në krah do të më hidhesh të më pushtosh: —
«Baba!»

Të pres, të pres o foshnje, si rrezet e agimit,
kur dhoma jonë do shkëlqejë
me buzëqeshjen më të ëmbël të gëzimit
që zemra mund të ndjeje!



DËSHIRË

Im bir lodron dhe hapi një sirtar,
gjen letra dhe shpejt rendën i gëzuar,—
m'i zgjat dhe qesh: — «Na babi!» Kur ia mar
filloj që t'i lexoj i përmalluar...

...Sa shkuan? Pesë, gjashtë, dhjetë vjet
që kur i pata shkruar ndonjë natë
prej maleve o poshtë në bregdet,
për ty, me qjell të pastër e shtërgatë.

Të vjetra janë letrat... Shkrimin tim
e rilexoj në heshtje i tronditur...
I lumtur dhe fat-keq, por me besim
e mbrojta dashurinë duke pritur!

Ka mbetur e skalitur sot çdo fjalë,
çdo ledhatim dhe çdo qortim jeton.
Avitet djali i vogël me ngadalë
ta përkëdhel... Dhe dorën ma lëmon.

Iliri im i shtrenjtë do të rritet!
I lumtur do të isha, o moj grua,
sikur të dashuronte, kur të kalojnë vitet
ashtu si të kam dashur dhe të dua!

DY BOTE

NË HARLEM¹⁾

Po qan një nënë në Harlem, po qan,
drejt qjellit nata thirrjet i shpërndan.
Pa qan e vetme fare
dhe shiu i përplaset në dritare.
Një djalë kish në botë,—
një djalë kish, për 'të po derdh sot lotë,
se s'do t'i kthehet kurrë në shtëpi,
s'do ketë as të ftohtë, as uri!

Mesnatë... Fryn egër murlani,
si hije, tej pyllit, numbet Ku-Kluks-Klani...
Fryn era... Larg zërin ka shpënë,
i duket se djali thërret: — »ku je nënë?!«
Fryn era, zezakun përkund
të varur në pyllin pafund!

E çmëndur bredh nëna në natën e nxirrë;
zezakun e shtrenjtë kërkon.
Qesh nëna dhe mbetet në vënd si e ngrirë
me flokë e rëna... Dhe qesh... Dhe vrapon!
Qesh nëna e çmëndur në mes të stuhisë
dhe qan e turpëruar Statuja e Lirisë!

1) Lagja e zezakëve në Nju Jork.

ËNDRA TË VRARA...

Marsilja
me këngë dhe puthje
u zgjua,
me ngjyra
çdo shëlg e çdo gur.
Qesh djali i lumtur: — «Të dua!»
dhe vajza këndon: «Mon amour!»

Po ngjiten të dehur
në dritë e hije,
lëndina
mbi kodrën jeshile i pret,
Në det
prej së largu
po vijnë anije,
dhe zhduken anije në det!

Marsilja
me këngë dhe puthje
u zgjua,
dhe çifti i lumtur
me ëndra kalon.
Ajo i hedh krahun e njomë:
— »Të dua!«,
ay fishkëllen »Se si bon!»

Ashtu do jetojnë,
me ëndra dhe shpresa,—
rinia e kaltër u fal dashuri,
një ndjenje
të pastërt,
të freskët si vesa
që ulet mbi lulet dhe barin e ri,

Mesdheu
po çlodhet i qetë,
dhe qjelli pa re kaltëron.
—»S'do ndahemi
kurrë
në jetë!«
betohen të rinjtë me afsh dhe pasjon.

Në çastin e lumtur
me djell të ndriçuar,
dëgjohet
papritur
më larg një buri,—
dhe mbeten
të dy të menduar, —
çjerr heshtjen burija, buçet përsëri!

— 2 —

N'Afrikë
do shkojë
me armë anija.
po nisen rekrutët atje.
Valvitet në erë
shamia,
qan nëna,
qan nusja e re!

Do niset anija...
O miq, lamtumirë!
Dhe vajza e mjerë po qan
në bregdet,—
i duket si ëndër
dhe mbetet e mpirë,
rekrutin që ikën me mall përshëndet!

Marsilja
zvoglohet,
s'po duket më fare,—
por vajzën e dashur
e sheh përsëri...
Ajo rri e heshtur
dhe pret
në dritare,—
do kthehet rekruti i ri...

Dikur
u betuan
të dy mbi lëndinë
se kurrë s'do ndahen,—
nuk vdes ky betim!
E rruan të shënjtë
në gji
dashurinë,—
e pret të kthehet,
e pret çdo agim!

— 3 —

Me palma
dhe plumba
i pret Algjeria...
Po pse i dërguan,
pse erdhën këtu?
O vënd i panjohur,
me rërë,
xhamija,
me vajza ndër male dhe qjellin më blu...

Ata ëndëronin
të rronin
të lirë,
me vajza,
kitara,
me gas në shtëpi,—
por vjeshta i gjeti
n'Afrikë të shtrirë,
me pushka dhe bomba të vrasin fëmi.

Dhe deti
dhe fushat
dhe kodrat
dhe malet,
dhe era dhe qjelli sikur i mallkon.

Marshon
bataljoni i lodhur,
nuk ndalet,
komanda
«Përpara në sulm!» — urdhëron!

—«Marshoni!»
Në krye çan udhën përpara
majori
me pishën e ndezur në fshat.
Po ndizen çatitë...
Dëgjohen të qara
dhe thirrje...
Mallkime të nënës pafat!

.. Marshon bataljoni
dhe shkel mbi kufoma...

—«Sulmoni, përpara!»
majori thërret.
Rekruti i lodhur po ecën akoma
në rrugën me pluhur ku qjelli humbet!

Drejt shtegut,
papritur,
kërcet batareja...
Në sulm
algjerjanët
u hodhën me zjarr!
për nënat e mjera
dhe gratë të veja,
për foshnjat që vdiqën prej sulmit barbar!

Në kodër rrethohet
pa shpres' bataljoni,
dhe ëndrat
rrethohen këtu...
Kot çirret majori:
— «Sulmoni!»,
një vajzë më kot pret diku...

— «Marshoni!»
— «Marshoni!»
— «Sulmoni!»,
... Po ranë
në shtegun e ngushtë përdhe, —
dhe shpresat
dhe ëndrat
u vranë,
nën palmat jeshile,
nën qjellin pa re!

VAJZA NGA HIROSHIMA

Përveç 300.000 japonezëve që u vranë në Gushtin e vitit 1945, gjatë sulmeve atomike amerikane në Hiroshima dhe Nagasaki, edhe sot e kësaj dite në Japoni po vdesin njerëz të prekur prej radio-aktivitetit.

Me zemren e plagosur po ju shkruaj;
ju shkruaj duke patur vdekjen pranë.
Në Japoni u linda edhe vuaj
se jam e re dhe lotët nuk m'u thanë.

Si çdo fëmi, dikur kam ëndëruar
të qesh, të bredh në ditët pranverore, —
por ja se nuk më lanë të gëzuar,
ma vranë buzëqeshjen fëminore.

Më duket si një ëndër aq e gjatë, —
dhe dua ta harroj por s'mundem kurrë.
Skëterra përsëritet për çdo natë
se shuhem dalgandalë e sëmurë.

E dashuronja qjellin, qjellin tonë
me një gëzim të madh, të pashpjeguar.
Qendronja natën në oborr gjer vonë
kur hëna ishte duke udhëtuar.

As që më shkonte mëndja ndonjë ditë
se lart prej qjellit tim plot yje e hënë
do binin zjarr dhe helme mbi fëmitë,
të lebetitej foshnja: — «Nënë! Nënë!»

Kur ra e pamëshirshme vetëtima,
u shkrijnë edhe gurët me një herë.
Varr i zbuluar mbeti Hiroshima
me hirin që shpërndaheste në erë!

Dhe djelli lart në qjell sikur u shua,
dhe oqeani sikur mbeti-i ngrirë.
Atje në kopsht më gjeti edhe mua,
m'i hodhi thonjtë vdekja pamëshirë!

S'kish lule më dhe bari ish zhuritur.
U ngrita e plagosur, si e marrë.
Dhe zemërën e ndjenja të cfilitur
kur shkelnja, e tmeruar, mbi të vrarë.

Kudo na ndiqte vdekja si një hije, —
e sillte vdekjen shiu, era, retë,
një fije bar, po, kushedi një fije,
e ndoshta edhe kuklla ime e shkretë.

Isha fëmi dikur, por sot u rrita
dhe vyshkem si një lule e këputur.
Dua të rroj, po e kuptoj përdita
se po më vret ky helmi i padukur.

Ju dashuroj, o njerës punëtorë,
por trupi im shpërndan sot rrezatime.
Kur digjem si qiri, në këtë orë,
nuk mund ta përqafoj as nënën time.

Në këto çaste s'kam veç se një shpresë,
që trupi duk'u djegur, të ndriçojë.
dhe kur të shuhem, zemra të mos vdesë,
me ju, për paqë, bashkë të luftojë!

MIRË SE NA VINI MIQ TË SHTRENJTË!

*Kjo këngë është shkrojtur me
rastin e ardhjes së N. S.
Hrushovit në Shqipëri.*

— këngë —

1

Ju presim miq si pritëm Djellin tonë
që lindi tej nga Lindja në Tetor,
e do ndriçojë botën gjithëmonë
në çdo agim m'i lart e madhështor.
Ju presim miq si pritëm dje Lirinë, —
në sytë tonë një shkëndi po ndrit, —
gëzim e krenari për Shqipërinë
e madhe një miliard sot shkëmb granit

Këthesa:

Mirë se na vini miq, mirë se na vini,
pranvera që lulzon ju përshëndet!
Çdo vatër që mer dritë nga Kremlini
me bukë e kripë e zemër po ju pret!
Mirë se na vini miq, mirë se na vini,
buçet nga zemrat tona ky urim!
Në zemrat tona rron vigan Lenini
që na jep forcë, shpresë dhe guxim.

Ju përshëndesin bjeshkat heroike,
çdo shkrep ku rrodhi gjaku për liri,
dhe arat me kombajnat sovjetike,
çdo shteg i vjetër dhe çdo fshat i ri.
Ju përshëndesin valët bregdetare
dhe kreshtat ku jeton krenar çdo lis.
Për ju edhe natyra shqipëtare
me petkun më të bukur e stolis!



FATMIRA

— 1 —

Fatmira rri mbështetur në dritare,
këngët krenare rrugës i dëgjon,
por sonte nuk shikon dot fyshek-zjarre, —
e verbëra as yjet s'i shikon!

E humbi dritën, mbeti n'errësirë,
në mes të zjarrit mbeti në rrebesh.
E humbi dritën por jeton e lirë
dhe sonte në dritare buzëqesh!

Era e vjeshtës ëmbël ia puth ballin,
era e vjeshtës tingujt i shpërndan.
Këngët e festës po ia nxjerrin mallin
e këngëve rreth zjarrit partizan!

Dhe si qëndron ashtu në dritë e hije
m'e bukur duket vajza se një yll.
Po ndjen, e verbër, çaste lumturije
edhe qepallat dalngadal i mbyll.

— «Tirana ime, shpirti im Tiranë,
feston të parën natë në liri...
Avitu nëno, thuamë sa janë,
në mes të tyre zemra ime rri!»

Rrezet e hënës derdhen mbi fytyrë
dhe sytë sikur ndizen si dikur!
... Një çast, këtheji dritën, o natyrë,
të shohë si valvitet një flamur!

Një çast këtheji dritën për të parë
pranverën e Nëndorit çlirimtar, —
të përshëndesë trimat luftëtarë,
Ilirin ta pushtojë sot me zjarr!

Sulmoi në ballë për këtë fitore
që të shkëlqejë Djelli yn' i ri, —
e mundi errësirën shekullore,
por humbi vetë dritën për liri!

— 2 —

O frymëzim, sa larg që më ke shpënë...
...I pesti dimër malet zbardhëllon.
Fatmira është nënë, është nënë, —
por një e verbër foshnjen s'e shikon!

Dhe vajza do me nënën të vrapojë,
pas dore tërë gas ajo e mer:
— «Eja mama!»

...Por kush mund t'i tregojë
pse nëna rri e ngrirë si mermer?

Edhe sa herë foshnjen e ka pranë
prej ballit vijat dalngadal i ndjek.
Por vajza kur me mall pushton mamanë
akoma s'di pse nëna po e prek...

Sa keq të vjen kur tërë shpresat mbetën
te foshnja që të ngjet ty, vetëm ty, —
Sa keq të vjen kur ti i fale jetën
dhe s'e ke parë asnjë her' me sy!

Dhe disa herë bije në mendime.
Fatmira si e mpirë rri në vënd,
... Rinia, lotë, dhimbje dhe gëzime,
e tërë jeta po i vjen ndërmënd!

Kujton me mallëngjim kur u martua...
I dashuri u kthye natën von...
... Ish partizan:

— «O shpirti im, të dua,
ne bashkë do jetojmë gjithëmon!»

U përqaftuan si dy shok' të mirë
pastaj ajo i tha me lot' ndër sy:
— «Me mua jetën ti ke për ta nxirrë, —
Illir i shtrenjtë, jo, nuk jam për ty!

Ti je i ri... Mejtto se si do jetë
skëtterra pranë meje... Më harro!
Nga një e verbër ç'pret në këtë jetë?
Illir, rininë tënde mos dëno!»

Por nuk u ndanë dhe u lind fëmia, —
vdekja me jetën për një çast u mat, —
u ngrit e madhërishtme dashuria
mbi vuajtjen krenare, të pafat!

— 3 —

Do ta vështronte detin sot Fatmira,
në horizont do hidhte një shikim, —
ngre ballin, por nuk duket hapësira
me një vështrim të vrarë në luftim...

Zemra e saj'rinore, ditë e natë
e zhytur n'errësirë nuk ofshan, —
përplasat si një barkë në shtërgatë
që dallgët çan t'arrijë në liman.

Iliri, burri, shoku i pandarë
me 'të lundron, ëmbel i flet në vesh.
Dhe ndizen shpresat jetën për ta parë,
dhe gruaja e puth dhe buzëqesh.

Ay çaplos ngadalë disa fletë, —
e verbëra tregimin e dëgjon.
Po qan, po qan tani me lot' të nxehtë
se KARAKTERIN RUS i rilexon...

Loton, por janë lotët e gëzimit
se varg i shkojnë vitet si zinxhir.
Ndjen tërë madhështinë e tregimit,
shikon në terr të dashurin Ilir!

Lundron anija... Larg ndriçon bregdeti;
gëzim e krenari çdo zemër ndjen.
Mbështetur në parmak Fatmira mbeti
nuk e shikon Odesën si shkëlqen!

Por ajo shkel në fushat sovjetike
me shpresën e fuqishme se tani
do të shikojë tokën më fisnike,
në këtë dhe do lindë përsëri!

I hap qepalalt dhe pa frymë mbetet, —
lëvizin hijet, mjergulla rrëshqet,
dhe perdja e mallkuar nis e tretet,
Fatmira sot në lumturi humbet...

Si rri ashtu, me shpresën e pandarë,
dy sy, dy sy të kaltër sheh ajo.
Sy më të kaltër kurrë nuk ka parë, —
qesh Filatovi:

— «Oçjen harasho!»

Dallohen muret, lampa, një dritare,
përtej një dallëndyshe dhe një gjeth.
Tani sodit natyrën fitimtare,
i duket se çdo gjë shkëlqen për rreth!

Bulojnë pika loti, mallëngjimi...
Aty i duket, për një çast, sikur
po nis një tjetër jetë nga fillimi,
i duket se flak tutje një qivur.

Jeta e pret të hidhet ndër beteja,
ajo në krahrëor një thirrje ndjen.
Do ngjitet drejt fitoreve të reja,
shikon me gas, të ardhmen që shkëlqen.

Iirin drejt në sy do ta vështroje!
E verbëra, e verbëra shikon!
Dhe do t'i buzëqeshë të kuptojë
se dhimbja u varros përgjithëmon!

Fotografinë e vajzës do ta marë
dhe syçkat do t'i puthë papushim.
Do t'i shikoje syt' për her' të parë, —
s'e pati gjer tani këtë gëzim.

Dhe tërë dhoma mbushet plot me dritë!
O dritë, pranë djellit ti na mban.
Vetëm ay që të humbet një ditë
t'i çmon me dhimbje rrezet që shpërndan.

Gremiset errësira ndaj agimit,
me mall Fatmira dritën përçafon.
Ndjen vehten si të çmëndur prej gëzimit
dhe shpëtimtarit dorën ia shtrëngon.

Oh, Filatovi është kaq i thjeshtë, —
gëzimin e shqiptarkës po e ndjen.
Jo, zemra e Fatmirës s'mund të heshtë,
në mirënjohje pakufi shpërthen:

— «Lavdi, lavdi o tokë e ndriçuar,
ti na dhe jetë, paqë dhe liri.
Nga Lindja Djelli ynë ka aguar,
nga Lindja erdhi drita përsëri!»



S A T I R A

SKLLEVËR DHE TË LIRË

Kongresi i Sh. B. A. shpalli «javën e popujve të skllavëruar» për të «çliruar» popujt e shteteve të demokracisë popullore.

Këmbanat thërrasin besnikët pagdhirë
dhe kisha po mbushet tani përsëri.
Po hyjnë padronë me zemër të mirë
që vrasin në punë dhe gra dhe fëmi...

Ka ardhur të lutet një mbret pa kurorë
dhe krye-manjatë me sy si mermer
që hedhin në rrugë miljona puntorë
të rojnë në Botën e «lirë» me nder!

Pronarë me mijra zezakë argatë
të mbetur përpara Linkolnit ashtu,
të krusur në arë për bukën e thatë
që kanë të drejtë të hanë dhe dru...

Policë të dashur përkrah me gangsterë,
banditë të ndershëm që s'dijnë hile,
u mblodhën të gjithë këtu me një herë
që Zotit t'i luten... Po vallë, përse?


Për miqtë padronë, andej të shpërndarë
n'Evropën Lindore ku s'kanë liri
të thithin më gjakun ashtu si më parë
dhe jeta u duket tamam skllavëri!

I VETMI ILAÇ

Në fushën pambarim të historisë
në ballë rendte kali amerikan
m'i pasuri i tërë njerëzisë
dhe shiste mëndje janki kapedan.

Por sot kapitalisti i kapitur
me Krizën në kuriz po rend nevrik.
Kthen kokën dhe vështron i raskapitur
se si avitet kali sovjetik!

Mbas disa vjet do ngelë pas qyqari,
S'i bën dobi asnjë tagji dollar.
Do mund të mbetëj gjithëmon i pari
sikur ta lidhte kohën me litar!



RROTA

Ju lutem, mbyllni sytë dhe mendoni dikur se si ka ndodhur kjo çudi...
... Pa frak, zhoben dhe pa çorap najloni majmuni i tha vehtes: — «Jam njeri!»

Desh sa më shpejt ta shpinte para botën, —
vrau mendjen ditë-e natë... si e qysh?
I nisi çpikjet më në fund me rrotën
drejt t'ardhmes që të merte shpejt grysh.

U çpik dhe rrota... Bota ish mahnitur!
E kush s'e priti rrotën me gëzim?
Por dolli komisjoni krejt papritur
që do ta merte rrotën në shqyrtim...

Dhe komisjoni nisi punën mirë,
operativ, i matur dhe zyrtar.
U mblodh nja dhjetë her' gjer ndaj të gdhirë
edhe e futi rrotën në sirtar!

I shkreti çpikës, nisi të trokasë
m'i mplakur, m'i dërmuar për çdo vit.
I theshin vazhdimisht: — «Dhe fort s'do zgjasë,
prit edhe pak... Durim... Mos u mërzit!

Dhe priti mijra shekuj, më besoni,
të aprovohet çpikja... Por më kot!
Ish burokrat i heshtur komisjoni
por si ndonjë tek-tuk që kemi sot.

Më ndonjë shpellë dhe tani më thanë,
ala po mblidhen sepse... domosdo
mendohen: «A ia vlen barra qiranë
ta aprovonjë çpikjen apo jo?!»

STINAT E DËNUARA

Më parë edhe stinat jetonin pa dallime,
por ja se Perëndisë i shkrepri një agim
që t'i ndëshkojë ashpër se bënë ca gabime, —
sejCILËS, sipas qefit, i dha nga një dënim...

Dhe vera u dënua të digjet kurdoherë...
Por vera prej dënimit nuk derdhi asnjë lot.
I poqi shpejt të lashtat dhe zbukuroi çdo derë
me lule dhe me këngët e punës për çdo mot.

— «E zymtë le të mbetet pa dallëndyshe, vjeshta!»,
ky ish dënimi-i Zotit... Por vjeshta nuk u mund,
i mbushi shpejt hambaret dhe rendi nëpër vreshta
ta ngrejë lart dollinë, ta pijë gjer në fund!

— «Dhe dimrin ta mbulojë dëbora përgjithmonë!»,
por dimri ngrohu farën e grurit nënëdhë,
dhe ndezi zjarr ndër vatra ku flaka deri vonë
i përqafoi përallat e gjata në Shëndre!

— «Të gdhiet çdo pranverë me erëra stuhije!»
por e paijsi dheun pranvera me stoli,
me zogj, me bar, me shqera, me ëndra dashurije...
— «Parajsën, — i tha Zotit, — nuk po ta kam zili!

JE I DASHUR DHE I MIRË...

Je i dashur dhe i mirë, —
lum si ne, të kemi mik...
...Buzëqeshjen e shët lirë
që të dukesh simpatik...

Je i ëmbël si sheqeri,
xhevahir në muhabet.
Ty të rroftë karakteri
se të nxjerr në shëmet

Je tamam njeri me vlerë,
na ke shpirt e na ke xhan.
Veç nga pas ti ndonjë herë
gabimisht sikur na shan.

Por je miku yn' për besë,
se për ne të ha merak.
...Ndaj na shan ti në mungesë
mos na prishet ndoshta gjaku!

HAXHI - PISHMANI

Pishmani, në rini kish ëndëruar
të bëhej qytetari m'i dalluar.
Desh në fillim të quhej inxhinjer,
pastaj mbas pak e ktheu veteriner,
edhe më vonë miku dalngadalë
filloi të ëndërojë për të dalë
o arhitekt, piktor, o profesor,
së paku agronom, shkrimtar, doktor...

Çdo profesjon e merte me dëshirë,
i dukej në fillim si jo më mirë,
vetëm pastaj nuk gjente dot derman
se miku ynë bëhej shpejt pishman.
S'kish faj! Nuk e harronte dot zakonin,
si mbreti gratë ndronte profesjonin.
Pishman pas pishmanllëkut, kaq e pat,
Haxhi Pishmani mbeti pa zanat!

* * *

Kur shkuan vitet deshi të martohet...
Na ëndëronte miku të gëzohet
çdo natë me lesh — verdhën, me zeshkanen,
ia donte zemra veç dhe sy-bajamen!
Oh sa e ëmbël është dashuria,
ia kishte marrë mëntë shtat-selvija, —
pëlqente dhe të shkurtrën dhe të gjatën,
bënte kabull të trashën dhe të thatën.
Për syt' e tij asnjë nuk kish të sharë...
Por kë të lerë edhe kë të marë?

I mjeri për çdo zemër kot ofshani,
s'e zgjodhi gruan dot Haxhi Pishmani.
U mat e u stërmat më kot i shkreti,
edhe në pleqeri beqar na mbeti!
Ashtu i ngrysi ditët, pra të shkretën,
u bë pishman Haxhiu tërë jetën...
... Shyqyr se më në fund ky kapedan
u bë pishman që bëhej shpesh pishman!



RRËNKIMET E NJË «PATRIOTI»

Mendon ish deputeti i tretur n'ëndërimë:

— «Zogolli bënte zgjedhje... Medet, të kish lezet kulltukun ta fitonje një herë në votime!»

— «Kur desh edhe Lal Kroshi të dilnje deputet!»

— «E si të mos e ngrinim në qjell Lartmadhërinë që siç e thotë kënga ish tigër e luan..

Për Zotin' ne e deshnim me zemër Shqipërinë dhe shkriheshim çdo ditë për komb...»

— «...E për sahan!»

— «Patriotizmin tonë të pastër, të kulluar si trashëgim e patëm, ohu, den-baba-den

se jemi Shqipërtarët e fisit të nderuar, dhe mbronim mëmëdhenë...»

— «Me frak e me zhoben!»

— «O kryepreq të shtrenjtë; ku jeni ju xhandarë, aman, po ju prefekta që dilnit me bajrak

në ditët e votimit, si shokë të pandarë dhe popullin sqaronit përhera...»

— «...Me dajak!»

— «O kohëra të arta! Në parlament një herë votonin baballarët e popullit shqiptar, dhe djersët çurg na rridhnin për njerëzit e mje-

rë...»

— «... Për 30 napoleonat (në muaj, franga ar...)

— «Dhe sot po bëhen zgjedhje... Për ne veç s'kanë shije

askush s'po na varr torbën këtu në Shqipëri, —

nuk mund të japim prova më atdhe-dashurije...»

— «Se populli i lirë tani zgjedh bijt' e tij!»

BLETA DHE MIZA

(Sipas T. Mënesku)

Një mizë kali, një ndajnate vere
si fluturoi, u ul mbi një koshere
ku hëngri mjaltë miza e uritur
gjer sa u ngop... Dhe foli e mërzhitur:

—Nuk më pëlqen ky mjaltë... S'bën një pare
se ka një erë që s'durohet fare!
Si e dëgjoi, bleta shpejt ia priti:
— «Kritika jote, mizë, s'më habiti...

Nuk më vjen keq se ti shan punën time,
prej teje nuk pres kurrë lavdërime...
... Si mizë kali fort ke udhëtuar,
me erëra të ndyta je mësuar!

ZEUSI DHE MUZA

Kur Zeusi dha urdhër të mblidhet sa më parë
rreth Fronit madhështor
i tërë kolektivi mes reve i shpërndarë,
(kush me shërbim, o ndoshta kush me pushim
vjetor)

atje majë Olimpfit u paraqit çdo Muzë
të jepte llogari
përpara Perëndisë që rrinte hundë-e buzë
se në raport kritika do kishte përsëri!

— «Dëgjoni, — tha Zeusi, — flas për të fundit herë,
burokracia juaj s'më pëlqen!
Nuk dua lavdërime dhe fjalë kot në erë,
mos rrini veç ndër qjeje, por zbrisni në teren!

Ç'po më shikon ERATO 1). . . Nuk di ç'po ndodh në
botë?

Me uh, me ah, me oh-e shpesh thurret poezia.
T'u thuash se u ngopëm me vajë e me lotë,
s'ka vetëm dëshpërime dhe ndarje dashuria!

Avitu EUTERPI 2) se kam me ty dy fjalë.
Tregomë. . . Dramaturgët, ti sa i ke ndihmuar?
Më raporto pasnesër sa pjesë kanë dalë
një tragjedi për veprën e dështuar!

1) ERATO — perëndesha e poezisë.

2) EUTERPI — perëndesha dramaturgjisë.

Dëgjomë TERPSIHORA...¹⁾ Ke fjetur gjer më sot
Të hidhen ca bandillë si topi i futbollit.
Tregohu si kërcehet se nuk i duroj dot,
kujdes veç të mos trembesh prej ndonjë rok-en-
rollit!

DHE ti ORFE²⁾ qysh nesër shko poshtë dhe më
thuj
ç'po ngjet atje mbi dhe?
Nuk e marr vesh... Një këngë, shpesh herë në një
muaj
nga dy kompozitorë na del si këng'e re!»

1) TERPSIHORA — perëndesha e valleve.

2) ORFEU — perëndia e muzikës.

S'JA VLEN BARRA QIRANË...

Shkrimtarin tonë keni për ta parë,
i mbyllur brënda sonte ka dëshirë.
gë t'i tregojë botës mbarë
me mjeshtëri si shkruhet një satirë.

Dhe lindë poezia satirike, —
dhe shkruan, shkruan, n'kulm të frymëzimit!
...Aq fort kurdisi lirën poetike
sa që i plasën telat prej mundimit...

Medet, më kot u raskapit i gjori,
satira, as humori nuk u panë.
Gjer në agim i shkreti dha e mori...

Dhe kur e pa se humbi krejt davanë
na hoqi dorë mjeshtri, se humori
s'është'letërsi... S'ja vlen barra qiranë!

LAKRORI

Avitej dimri, dimri i dyzetekatrës,
murlani egër frynte në dritare. . .

Kërcisnin pushkë, kot i strukej vatrës, —
Po dridhej. . . Zjarri nuk e ngronte fare. . .

E shoqja, e kërusur dhe e zbetë
hollonte petët, zërin hiqte zvarë:

— «Të mjerët ne! Do vijnë!»

— «Rri e qetë, —

shif petët e lakrorit, moj e marrë. . .»

— «Të mjerët ne. . .»

— «Pusho të them, moj shtrigë, —

s'kam bërë gjer më sot

asnjë të ligë. . .

jam patriot. . . Mër vesh? Jam patriot!»

— «Por ishe dhe ministër fuqiptot!»

— «Ku mër vesh ti se ç'është politika,

rri e gatuj dhe mos fol përçart. . .»

— «M'u thaftë goja e më rëntë pika,

s'mar vesh, po them se ç'flitet poshtë e lart!»

— «Pusho he dreq, se asnjëri s'kam vrarë

punova veç për komb dhe ideal. . .»

— «Kush po të shan? Ne jemi der' e parë,

për hatër nuk të bënë federal!»

— «Moj, s'po mer vesh? A do ta mbyllësh gojën

se po t'u ngrita, ti e din pastaj. . .

Paske ndërmënd që të më nxjerrësh bojën?»

— «Jo, unë e shkreta hallin po ta qaj. . .

Kam frikë atë firmën e mallkuar

se thonë janë varur. . . pushkatuar. . .

Por mos u nxe me mua kot bre burrë. . .»

— «Moj, po s'pushove po të hedh në prush.

Me gjak nuk i kam lyer duart kurrë,
imzanë do ta vinte veç dikush!»

Kur hyjnë partizanët në Tiranë
i thirri gruas:

— «O zonj' e shtëpisë,
na bëj moj një lakror për djemtë tanë,
u lodhën mjaft në mal në mes stuhisë...»

Tek tuk dëgjohej larg ndonjë e shtënë,
diku po digjej ende një shtëpi...
..Burgu i ri akoma s'kishte rënë
por do të binte edhe kish gosti...
Lakrori gati... sofrat ishin shtruar
dhe verë kish dhe gjellë në sahan...
Njësitin partizan e kishte ftuar
se djemtë po luftonin për vatan.
Desh që t'ja mirte këngës i gëzuar,
por fryu prej Dajtit era e Nëndorit
edhe me vrull, papritur, pa kujtuar
ia hoqi petët një nga një lakrorit!

KRIJIMI I BOTËS

(Shkencë e vulgarizuar)

T ë dashur miq, ashtu sikundër thonë,
botën e bëri Perëndia jonë.
Se kush ia porositi s'kam kuptuar,
por, siç e dini, duke e ndërtuar
në një filan Ndërmarrje të Gjithsisë
më tepër rëndësi i dha sasisë.
Nuk bëri pra një punë kaq të saktë,
s'e nxorri lëmshin krejt të rrumbullaktë
por pak të shtypur, poleve të prerë
si një tavan që bark lëshon shpesh herë!
Pra qysh ditën e parë të krijimit
filluan dhe avazet e Ndërtimit. . .

Vazhduan taksiratet e kijametit!
Siç dihet, tre të katrat e planetit
i bëri vetëm ujë Perëndia,
me ujë u mbulua gjithësia.
Pra mbetën fare pak toka të thata
ku sot shpërthejnë turli inondata
dhe uji hyn me vrull tani shpesh herë
në qumësht e në verë!

Si bëri kafshët, mori balt' e ujë
dhe ngriti, si skulptor, shpejt një statujë,
(pa marrë paradhënje, pa kontratë
me një afat nja dhjetë vjet të gjatë
siç ndodh tani, kur marrin shpesh paratë
dhe i harxhojnë tërë frymëzimet

pa mbajtur angazhimet. . .)
Ashtu lindi ndër ne i pari burrë
fatkeq se grua s'kishte parë kurrë.
Dhe rrinte, hund' e buzë, i mërzhitur,
të dashurën e zemrës duke pritur.

Nuk kishte faj Adami, jo të shkretën,
pa grua, si do rronte tërë jetën?
E deshte gruan, besa, me gjith'zëmër,
jo që të bridhte kot, femër më femër. . .
As që mendonte ndoshta byrazeri
ta ndante se s'i pugej karakteri.
Kur më në fund dhe Zotin troç e luti,
një brinjë Perëndia i këputi,
dhe nga kjo brinjë — e thyer
na lindi Eva, gruaja e vyer!
Ndoshta prandaj tani disa në jetë,
t'i marrin hakun Adamit të shkretët
i rrahin gratë sa u mban takati
dhe u coptojnë brinjët nga inati!

Lart në parajsë s'kish as re, as mjergull,
si veshje Eva kish një fletë pjergull.
Një fletë pjergull, po, vetëm një fletë,
dhe bridhte në parajsë posht'—përpjetë. . .
Prandaj dhe sot, dhe sidomose në verë
na dalin disa vajza, — shënd e verë —
me dekolte, se këto vajza, xhane,
me gjysmë metro qepin tre fustane.
Veç t'i shikosh, kur shtrihen në lëndina
se sa lezet u ka gjoksi dhe shpina.
Pak e nga pak vjen moda si qëmoti,
po ndjekin modën q'e ka çpikur Zoti!

PËRMBAJTJA

| | Faqe |
|--|------|
| Yjet nuk shuhen | 3 |
| I. AGIMI YNË | |
| 1. Kujtime fëminije | 5 |
| 2. Në muret e kështjellës shekullore | 10 |
| 3. Romanca e Hënës | 11 |
| 4. Këndoj | 12 |
| 5. Agimi ynë | 14 |
| 6. Zgjimi i metaleve | 16 |
| 7. Bregdeti | 17 |
| 8. Shtegu i harruar | 18 |
| 9. O fshati im i dashur | 19 |
| II. NJERIUT TË MADH E TË THJESHTË | |
| 1. Parëverë | 21 |
| 2. Tryezë e vogël | 22 |
| 3. Në Shushenskoe | 23 |
| 4. Përpara, shokë proletarë | 25 |
| 5. Në zëmrat proletare | 26 |
| 6. Lokomotiva 542 | 27 |
| 7. Viti i urisë | 28 |
| 8. Zëmra e Leninit | 29 |
| 9. Flamuri i kuq valon i lirë | 30 |
| 10. Xhaketa e arnuar | 31 |
| 11. 12 dhjetor 1922 | 32 |
| 12. Apasionata e Bethovenit | 33 |
| III. POEZIA E JETËS | |
| 1. Poezia e jetës | 34 |
| 2. Skënder po flas me ty | 36 |
| 3. Shtëpia e rënuar | 37 |
| 4. Heroi në timon | 38 |
| 5. Këthehen punëtorët në shtëpi | 40 |
| 6. O rrugë mali | 41 |
| 7. Shënimet politike | 43 |
| 8. Në parakalim | 44 |
| 9. Lumturia | 45 |
| 10. Te çezma e vashave të bukura | 50 |
| 11. U shojt një yll | 51 |
| 12. Buzëqeshja | 54 |